



KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverballi i mbajtur më 04 mars 2019, në mbledhjen e XVI (gjashtëmbëdhjetë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm, nga 35 këshilltarë/e të Kuvendit të Komunës, prezent ishin 34, kurse një anëtar nuk është zëvendësuar ende nga KQZ (Lista e nënshkrimeve)

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, Drejtorët e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të OJQ-ve lokale (Rrjet i OJQ Lokale), përfaqësues të mjeteve të informimit dhe mediaeve, dhe një numër i qytetarëve.

Rendi i Ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, i njoftoj rreth pikave të rendit të ditës dhe konstatimeve nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

z.Fitim Haziri, theksoi, bazuar në nenin 39.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nenin 65.1 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës si dhe nenin 33 të Statutit të Komunës së Podujevës, në këshilltarët e Lëvizjes Vetëvendosje në Komunën e Podujevës, i propozojmë Kuvendit të Komunës së Podujevës që të shtoj një pikë të rendit të ditës, një propozim vendim që ka të bëjë me Kompaninë private për distribuim dhe furnizim me energji elektrike – KEDS, t'i ndalohej vendosja e njehsorëve për matjen e energjisë elektrike në shtyllat e rrjetit elektrik në hapësirat publike në tërë territorin e Komunës së Podujevës. Arsyeja e këtij propozim vendimi është se kemi vërejtur që kohëve të fundit KEDS në disa fshatra dhe lokacione të Komunës së Podujevës ka vendosur njehsorë në maje të shtyllave elektrike gjë që qytetarët e Komunës së Podujevës nuk kanë qasje në gjendjen e llogarisë dhe shpenzimeve të energjisë elektrike në këta njehsorë, kështu që presim nga ju që të mbështetet kjo pikë shtesë e rendit të ditës dhe të diskutojmë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, do të thotë kemi një propozim nga shefi i Grupit të këshilltarëve nga radhët e LVV-së që në rend të ditës të shtohet për debat edhe pika të cilën e potencoj ai, përkatësisht çështja e njehsorëve në shtylla elektrike, lartë në shtylla.

z.Avni Fetahu, theksoi, propozimi në fjalë, si i tillë sikur të sillej ndoshta në KPF do të lehtësonte punën paksa për diskutim nga ana jonë si këshilltarë të Kuvendit edhe pse ne në atë mbledhje patëm një diskutim të tillë rreth kësaj çështje. Fillimisht rreth këtij propozimi aq me nguti ne do të sugjerim që të jetë çështje për diskutim në kuadër të informatave që i ka edhe Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit por edhe Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, pra në ato informata të diskutohej edhe kjo çështje e cila është shqetësim i të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës, apo në konsultim edhe me Kryesuesin e Kuvendit të mbetet si pikë e fundit për diskutim që mos t'i ngarkohet si barrë pikës që e kemi tek Drejtoria e Pronës

Kadastrit dhe Gjeodezisë, propozimit për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim Kompanisë KEDS, pra mos të ngarkohen dhe mos të ketë ndërlidhje mes këtyre dy pikave. Ne në parim jemi që çështja e cekur të diskutohet dhe më me kënaqësi do të përgatiteshim në ndonjë seancë tjetër, mirëpo nëse është vullneti i shumicës nuk ka ndonjë problem, e diskutojmë edhe në këtë mbledhje.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, rreth propozim vendimit që e paraqiti këshilltari parafoles z.Fitim Haziri, është e vërtetë se me vazhdimin e punimeve që është duke bërë Kompania KEDS, është një problem të cilin e kemi trajtuar disa herë madje edhe si Grup i këshilltarëve nga PDK e kemi ngritë, konkretisht bëhet fjalë për vendosjen e orëve elektrike top-up dhe këtë vazhdim të punëve të KEDS e kemi kundërshtuar. Është e vërtetë që Kompaninë KEDS e kemi mbështetë në vazhdimësi për kërkesat që ka pasë në Komunën e Podujevës për vendosjen e trafostacioneve dhe zgjerim të rrjetit në mënyrë që rrjeti elektrik të përfordhet dhe qytetarët të kenë energji elektrike, mirëpo ka vazhduar me diskriminimin tjetër me mos lejimin e qasjes në shpenzimet e konsumatorëve. Është e vërtetë që Kuvendi i Komunës duhet ta ketë qëndrimin e vetë. Përmes disa punimeve që janë duke u bërë nga KEDS në disa fshatra si Shajkoc, pastaj shumë shpejt pritet të filloj në Shtedim, KEDS është duke vazhduar avazin e njëjtë e që gjatë këtyre ditëve subjektet politike duke përfshirë edhe LDK-në kanë pasë ankesa direkte nga qytetarët për mos qasje në faturat e fundit ku ka pasë fatura deri në 180 € për një ekonomi familjare dhe të njëjtit nuk i kanë lejuar KEDS që të shikojnë KW e shpenzuar, e që është shkelje direkte e të drejtave të konsumatorit, kështu që jemi në dijeni se lejimin e këtyre punëve e ka bërë Ekzekutivi i Komunës, konkretisht kur unë kam kërkuar në atë fshat se si po bëhet kjo, përfaqësuesi i KEDS më ka ofruar një dokument se ka leje nga Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, përkatësisht Drejtori z.Hmandi Jaha i cili ka lejuar vazhdimin e vendosjes së atyre orëve, kështu që edhe ne kërkojmë që sot Kuvendi të ketë qëndrimin e vetë rreth vendosjes së orëve top-up dhe në këtë aspekt ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e kundërshtojmë vendosjen e orëve të tilla në shtylla elektrike, dhe mos lejimin e shikimit të shpenzimeve të KW nga ana e qytetarëve që mendoj se është shkelje direkte e të drejtave, kështu që ne është mirë të marrim sot një vendim ose të paktën të kemi qëndrimet e subjekteve politike të përfaqësuar në këtë Kuvend. Unë e kuptova edhe z.Avni Fetahun, mirëpo është e drejtë që në Kuvend të propozohen pika për përfshirje në rend dite, por i nderuar Kryesues i Kuvendit besoj se edhe të tjerët duhet ta mbështesin këtë propozim, edhe pse është nga një subjekt opozitar, sepse është në interes të qytetarëve, kështu që nëse sot nuk marrim një qëndrim rreth vendosjes së orëve top-up në shtylla elektrike, problem për të cilën jemi duke diskutuar që afro një vit dhe asnjëherë nuk kemi pas ndërprerje të kësaj, apo nuk kemi pas vëmendjen e Ekzekutivit të Komunës rreth kësaj çështje. Unë kam qenë i pari që e kam ngritur çështjen e vendosjes së orëve të tilla në shtylla elektrike. Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së nuk do të jetë pjesë e seancës nëse nuk është qëndrimi për t'i ndërprerë vendosjen e orëve top-up në mënyrë që qytetarët ta dinë sa po shpenzojnë dhe sa do të paguaj.

z.Patriot Rudari, theksoi, po thujse të parët që u janë vendos orët e tilla jemi ne në fshatin Shajkoc, gjë të cilën fillimisht e kemi kundërshtuar mirëpo kur e kanë paraqitur dokumentin e Ekzekutivit të Komunës sipas të cilit atyre u lejohet vendosja e atyre orëve elektrike, dokument të cilin e kemi parë dhe ishte nënshkrimi i Drejtorit z.Hamdi Jaha me të cilin lejohej vendosja e orëve në fjalë në shtylla elektrike. Prandaj ne jemi për një vendim i cili u propozua në fillim të seancës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, unë e hedh në votim fillimisht rendin e propozuar të ditës sipas materialit të dërguar sepse kemi të bëjmë me një aneks i cili propozohet ti bashkëngjitet rendit të ditës.

z.Avni Fetahu, theksoi, nuk është diçka e re kjo temë, por mendojmë se është mirë të jetë si informatë në fund të kësaj mbledhje në mënyrë që të shtjellohet dhe të pasurohemi me informata dhe

sqarime më të detajuara sepse ne nuk mund të marrim vendim këtu për këtu për një çështje e cila ia ndalon dikujt të vendos njëhisorë sipër në shtylla elektrike, çështje e cila është bukur shumë domethënëse të elaborohet por megjithatë po mundohem të elaboroj paksa. Procesin e privatizimit nuk e kemi diktuar ne si asamblistë ashtu siç nuk i kemi diktuar edhe shumë forma të tjera të investimeve që i ka bërë KEDS, nëse ne tani marrim vendim ende pa u dhënë në shfrytëzim një pronë për të vendos një shtyllë elektrike ose diçka e ngjashme, dhe ne pra marrim vendim që të vendosen njëhisorët sipër apo poshtë në shtyllë, më duket se paksa është një, andaj e përsërisë që ne mund ta diskutojmë fillimisht dhe pastaj mund të marrim vendim me votë të shumicës.

z.Bajram Ajeti, theksoi, po çuditëm paksa me disa qëndrime rreth KEDS, këtu ne si asamblistë jemi të obliguar të mbrojmë interesin e qytetarit dhe që qytetarët të mos diskriminohen sepse mos diskriminimi dhe trajtimi i barabartë i qytetarëve është i garantuar me Ligj dhe me Kushtetutë, prandaj këtu është në pyetje që qytetarët të mos diskriminohen. Në një lagje kemi ndoshta dhjetëra familje të cilave u janë vë njëhisorët në maje të shtyllave elektrike ndërsa të tjerave familje jo, pra këtu kemi të bëjmë diskriminim, pastaj sa jam në dijeni unë, e që si duke e paskeni harruar ju si duket, edhe Kryetari i Komunës para disa viteve ka reaguar kundër kësaj dukurie të KEDS, edhe unë mendoj se është plotësisht e arsyeshme, andaj mos të ketë propozime për informatë sepse propozimi ynë ishte shumë i qartë, të merret një vendim nga kjo assemble komunale që qytetarët të mos diskriminohen ku dikujt i vëhet njëhysori lartë në shtyllë elektrike dikujt poshtë, e që drejtpërdrejt në mënyrë flagrante shkelet parimi i transparencës sepse çdo qytetarë e ka të drejtën të informohet për shpenzimet që bën dhe për shërbimet që i ofrohen, andaj lidhur me këtë ne jemi të prerë rreth asaj që e paraqiti shefi i Grupit të LVV-së, si dhe sa vërejta ka përkrahje edhe të Grupeve tjera të Kuvendit të Komunës që këtu të merret vendim. Rendi i ditës mund të ndryshohet dhe është çështje e asamblesë kjo, madje nëse nuk dëshironi që pika e propozuar të futet si pikë e veçantë, mund ta fusim në kuadër të pikës 3 ku kemi të bëjmë me çështjen e dhënies në shfrytëzim të pronës komunale, KEDS-it, mirëpo të kërkohet të mos futet në rend dite si propozim vendim por të jetë vetëm informatë, nuk e shohë të arsyeshme sepse jemi mbush me informata, madje ju vetë e pranuat se ka me vite që jemi duke u marrë me këtë çështje.

z.Fitim Haziri, theksoi, i nderuar Kryesues, duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale, Rregulloren e Kuvendit, këshilltarit i lejohet të jap propozim për të shtuar një pikë të rendit të ditës. Një propozim të tillë unë e dhash, kurse është e juaja si Kryesues i Kuvendit që këtë propozim ta hedhësh në votim, nëse kalon e diskutojmë nëse nuk kalon u krye puna. Nuk është koha e debatit para votimit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përgjigje parafolësit, askush nuk e tha se nuk do të hedhet në votim, dhe nuk do të shkelen këto parime, mirëpo të drejtën që e ke ti si këshilltarë, e kanë edhe Grupet tjera dhe çdo këshilltar i Kuvendit të Komunës që të japin mendimin e tyre, e jo që po sa të jepesh ti një mendim, menjëherë i njëjti të hedhet në votim, por çështjet debatohen nga subjektet, nga këshilltarët e Kuvendit sepse janë të gjithë të barabartë, andaj lus të jesh paksa më i durueshëm dhe të dëgjoni edhe të tjerët.

z.Avni Fetahu, theksoi, kam edhe një sqarim shtesë në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së, ne nuk jemi kundër që propozimi i dhënë të hyjë në rend të ditës si pikë shtesë, dhe mos ta ngatërrojmë këtë sepse jemi që të hyjë në rend të ditës dhe e përkrahim për diskutim, mirëpo forma e propozimit që të merret një vendim menjëherë sot këtu ashtu siç u propozua mendoj se është paksa jo e sqaruar mirë. Kështu që jemi që ta fusim në rend të ditës, por jo të marrim vendim.

z.Avni Islami, theksoi, mendoj që propozimi i Grupit të këshilltarëve të LVV-së dhe brenga e tyre është e drejtë dhe të njëjtin shqetësim e ndaj edhe unë, çështje e cila jo tani por shumë më herët të rregullohej me ligj si dhe meqë tani jemi në këtë legjislativ t'i japim kësaj çështje një vendim, por që

nëse vërtetë nuk bënë që të futet në rend dite kjo çështje, të mbetet si obligim për mbledhjen e ardhshme dhe unë jam për, që kjo çështje të zgjidhet. Po ashtu jam kundër asaj që disa njehsor elektrikë të vendosen në maje – lartë në shtylla elektrike, ku vetëm me shkallë mund të arrihet të shikohen, kurse disa tjerë të vendosen poshtë në shtylla ku und të shikohen pa problem, pra kjo nuk është në rregull dhe mund të themi se është një diskriminim, andaj propozoj që në mbledhjen e ardhshme të përfshihet në kuadër të rendit të ditës dhe të merret vendim me një konsensus të përgjithshëm.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes dhe Mjedisit – DPUMM, theksoi, për sqarim, nuk ka asgjë të keqe që propozim në fjalë të hyjë në rend të ditës, mirëpo rreth asaj që u përmend emri im, unë ju them se në vitin 2014 investimet e KEDS janë ndërprerë për rreth dy javë me të vetmin qëllim që orët elektrike të zhvendosen nëpër shtylla. Kemi pas takim bashkërisht me Drejtorin e Inspeksionit dhe kemi arritur që ai ngërç të tejkalohet ku pastaj për tre vite janë bërë mbi 17 milion euro investime në Komunën e Podujevës. Sa i përket lejes që unë e kam dhënë, nuk është dhënë për të vendosur njehsorët lartë në shtylla por është dhënë për vendosje në shtylla poshtë dhe të jenë transparente. Mund t'ju them me përgjegjësi të madhe se në vitin 2015, në afërsi të SHFMU ‘‘DR Ibrahim Rugova’’ ka pasë një protestë të qytetarëve të cilët kanë ndaluar KEDS-in që orët elektrike të mos vendosen në shtylla ku pastaj përfaqësuesit e KEDS kanë ardhur në zyrën time dhe kanë deklaruar se kanë humbje shumë të mëdha në atë pjesë, dhe jemi rënë në dakord që për një muaj të vendosen orët në shtylla jashtë dhe të shohim dhe analizojmë gjendjen momentale, dhe në qofte se nuk ka humbje për shkak të vendosjes së orëve jashtë, atëherë duhet të vendosen sërish brenda, mirëpo në këtë aspekt me përgjegjësi të plotë ju them se rreth 95% ka dal se ka pasë hajni-vjedhje. Nuk dëshiroj në asnjë formë të mbroj KEDS-in sepse ajo është një kompani private e cila ka për detyrë të rregullojë rrjetin e energjisë elektrike, por ju them që pastaj ata qytetarë kanë ardhë në zyrën time dhe ju kamë treguar se si është gjendje dhe janë tërheqë. Ne të gjithë jemi në dijeni rreth gjendjes që kemi, por para Kuvendit mund të dalim si të dëshironi ju dhe do të jem me ju, mirëpo nëse ju dëshironi të merrni vendim që të gjitha orët elektrike të futen brenda, unë sot po ju garantoj se 6.5 milion euro që janë në këtë vit për investime në Komunën e Podujevës përkatësisht për 66 projekte të cilat i posedoj këtu, atëherë do të ndërpriten. Çështja tjetër, unë e kam përcjellë KEDS-it pyetjen e juaj që e keni parashtruar më parë, përse keni vendos orët elektrike në pjesën e lartë të shtyllave në një pjesë të territorit të Komunës së Podujevës, shpjegimi i tyre ishte, kjo ka ndodh për disa familje të cilat kanë bërë tentim për të bërë ndryshim në orët elektrike të cilat kanë qenë në pjesën e poshtme dhe i kanë vendos në pjesën e lartë, dhe ju kam shtuar pyetje, si ka mundësi që ne tani t'i bindim qytetarët që të njëjtët t'i shikojnë orët e tyre, përgjigja ishte, jemi duke bërë një program - data bazë të përgjithshëm në tërë Kosovën dhe për secilën orë kur shkojmë të shikojmë do të jetë me kamerë dhe do të jetë prezent pronari ku të bëhet incizimi andaj të keni durim. Pra kjo ka qenë përgjigja, prandaj unë sërish po ju them se çfarëdo që dëshironi mund të merrni vendim dhe unë jam në Ekzekutiv i cili do ta realizoj, mirëpo po ju them që realisht ka humbje të energjisë elektrike, mirëpo do të doja ta përfundojmë kompletë rrjetin elektroenergjetik që mund të zgjatë maksimum edhe 1 vit e gjysmë deri në 2 vite, dhe do ta shohim rezultatin, ne prap këtu jemi dhe nëse e shohim që nuk është reale ajo që po ndodh atëherë mund të marrim vendime të llojllojshme, mirëpo t'i lejojmë investimet të realizohen dhe të jemi vigjilent të gjithë bashkë. Unë ju garantoj se çdo vendim që do të merrni ju do të jem prapa juve, mirëpo nuk jam për të marrë vendime kur jemi në dijeni për një pjesë të qytetarëve se çfarë bëjnë.

z.Nexhmi Rudari, Nënkretar i Komunës, theksoi, po mundohem të jap kontribut në mënyrë që të dalim nga kjo situatë. Fillimisht dua të them se ne nganjëherë me apo pavetëdije po kontribuojmë në shkeljen e Rregullores së Kuvendit, e them këtë duke pasë parasysh që për këtë çështje u hap debat

dhe po diskutohet një çështje ende pa u miratuar rendi i propozuar i ditës, gjë e cila bie ndesh me Rregulloren në fjalë. Në mënyrë që të vazhdojmë të procedojmë dhe të dalim nga kjo situatë unë propozoj që çështja si diskutim, si pikë e rendit të ditës të futet në këtë seancë, por vendimi të lihet për seancën e radhës pasi të kompletojmë gjithë dokumentacionin dhe ta dimë se çka po bëhet. Besoj që seanca e radhës do të jetë në fund të këtij muaji, Ekzekutivi edhe Drejtoritë përkatëse do të bëjnë kërkesa – ankesa të ndryshme në KEDS, do të marrin informata dhe pastaj dalim me një qëndrim për marrje të vendimit, mirëpo kjo nuk do të thotë që ne sot nuk mund të debatojmë dhe t'i dëgjojmë këshilltarët një nga një për këtë çështje sepse kjo çështje na prek të gjithëve dhe nuk bëhet fjalë për subjekte politike ngase ashtu siç i'u intereson qytetarëve ashtu na intereson edhe neve individualisht secilit prej nesh. U dhanë edhe arsyetime rreth kësaj çështje, por unë mendoj se më e mira do të ishte që ta fusim në rend të ditës dhe të bisedojmë për këtë çështje.

z.Fitim Haziri, theksoi, prap po kthehem në atë që e rregullon punën e Kuvendit e që është Ligji për vetëqeverisje lokale, nen 47- rendi i ditës, thuhet, çdo këshilltar ka të drejtë të propozoj një pikë të rendit të ditës, askush nuk ka të drejtë që atë pikë të rendit të ditës të tentoj ta ndryshoj, ai këshilltar i cili e bënë propozimin. Propozimi ishte i kuartë, unë bëra propozim për një vendim të cilin e paraqita para jush që ta hedhni në votim, kalon apo nuk kalon, nuk kemi çka të diskutojmë më shumë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, faktikisht debat për këtë pikë nuk ka pasë, Drejtori i DPUMM z.Hamdi Jaha e tha që unë kam lëshuar një vendim për tu vendosur orët elektrike poshtë në shtylla, KEDS janë duke vendosur orët top-up lartë në shtylla, mirëpo çfarë është duke bërë Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit që nuk merret me zbatimin e vendimit tuaj si Drejtor i DPUMM. Ne këtë shqetësim e kemi paraqitë vazhdimisht në KPF por edhe në Kuvend, madje edhe para rreth 5 seancave kam shpreh shqetësimet e mia që vendosja e orëve top-up duhet të ndalet. Pra a ka dal ndokush të shikoj zbatimin e vendimit që ju e keni lëshuar si DPUMM, vendim për të cilin ne si këshilltarë nuk mund të bëjmë një gjë të tillë por mund ta ngrisim si çështje shqetësimin dhe ankesat e qytetarëve. Një vendim i tillë duhet të merret sot në këtë seancë, a jemi apo nuk jemi si Kuvend për vendosjen e orëve në fjalë lartë në shtylla elektrike, jemi apo nuk jemi të votohet, dhe nuk prish punë asgjë dhe është shumë në mënyrë transparente, Kuvendi i Komunës merr vendim që orët top-up të ndërpriten, pastaj Drejtori i DPUMM ta zbatoj vendimin konform ligjit, asgjë më shumë, në rast se nuk dëshiron të përfshij në rend dite si propozim, ne si grup i këshilltarëve të PDK-së e lirojmë sallën, kurse ju mund ta vazhdoni mbledhjen me rendin përkatës të ditës, ose votoni për vendosjen e orëve top-up, por po ju dhemb kjo për shkak se jeni në dijeni se jeni në kundërshtim me të gjitha normat juridike, mirëpo nuk po dëshironi të deklaroheni para mediave që LDK nuk po dëshiron të ngitë dorën, dhe tani ose ngriteni dorën kundër ose për. Drejtori i DPUMM e tha që duhet të presim dy vite që të përfundojnë investimet e KEDS në Komunën e Podujevës, mirëpo a e dini sa janë dy vite që të vendosen orët top-up dhe të faturohen pa pasur qasje konsumatorët, kjo është një banalitet i madh. Sa i përket problemeve të KEDS nuk më interesojnë bash asgjë, por ne vetëm këtu kemi përgjegjësi, dikush me Ekzekutiv dikush me legjislativ, dhe si përgjegjësi legjislative po flas vetëm për vete, jam kundër vendosjes së atyre orëve lartë në shtylla elektrike dhe kam qenë vazhdimisht prej që ka filluar një praktik e tillë. Është e vërtetë që Drejtori i DPUMM e ka thënë se do ta shqyrtojmë këtë rast, sa jeni marrë me këtë nuk po dëshiroj të dijë fare, por vetëm po dëshiroj të dijë se a mundeni ju si Drejtor Ekzekutiv që t'ia ndaloni një gjë të tillë KEDS-it apo jo, nëse jo deklarohuni, nëse po nënshkruani. Po të isha në vendin e juaj do t'i thoja Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit që nga tani orët top-up nuk do të vendosen më lartë në shtylla elektrike dhe nuk do të lejoja të vij deri te kjo situatë. Pra dikush të merr vendim, kompetenca është e juaja, propozimi është i joni si këshilltarë të Kuvendit, hidheni në votim këtë marrje të vendim, miratohet në rregull, nuk miratohet vazhdojmë me punë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe pse nuk kishte nevojë të bëhej një debat i tillë aq i gjatë dhe i panevojshëm, megjithatë propozimi është që të futet në rend të ditës sot në këtë seancë, si propozim vendim.

z.Avni Fetahu, theksoi, meqë po paraqitet nevoja edhe për një sqarim shtesë, dëshiroj të jap, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së, pas diskutimeve të bëra e konsiderojmë këtë çështje të sjellë nga shefi i Gripit të LVV-së i cili është sjellë si propozim që të futet në rend dite në këtë seancë, kur të vije koha, diskutohet dhe mund të merret vendimi për, po ose jo.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ju lutem edhe njëherë e hedh në votim këtë kërkesë që të hyjë në rend të ditës si propozim vendim, urdhëroni të votojmë.

Pas votimit u konstatua se njëzëri mbështetet propozimi që në kuadër të rendit të propozuar të ditës, në pikën 7, të përfshihet pika shtesë: Propozim vendimin që kompanisë private për distribuim dhe furnizim me energji elektrike, "KEDS" i ndalohet vendosja e njësorëve për matjen e energjisë elektrike në shtyllat e rrjetit elektrik në hapësirat publike në tërë territorin e Komunës së Podujevës. Ndërsa pika Të ndryshme kalon sipas radhës në pikën 8 në kuadër të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, e hedh në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe pikën shtesë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit, konstatoi se njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe pikën shtesë;

- ***Propozim vendimi që kompanisë private për distribuim dhe furnizim me energji elektrike, "KEDS" i ndalohet vendosja e njësorëve për matjen e energjisë elektrike në shtyllat e rrjetit elektrik në hapësirat publike në tërë territorin e Komunës së Podujevës.***

1. Ekstraktet e Procesverbaleve të mbajtura në mbledhjet e Kuvendit të Komunës më: 30 nëntor 2018 dhe 30 janar 2019.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk u paraqit askush, unë kam vërejtur një gabim ndoshta gjuhësor mund ta quaj, përkatësisht në diskutimin e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit z.Faik Muçiqi, në mbledhjen e mbajtur më 30.01.2019, në faqen 2 ku thuhet "Agresioni për Menaxhim Emergjent" termi "Agresion" ndoshta fjala është për "Agjension", andaj të korrigjohet kjo.

Pas votimit, u konstatua se njëzëri miratohen Ekstraktet e procesverbaleve, dhe atë:

- Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 30 nëntor 2019, dhe
- Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 30 janar 2019, duke përfshirë zëvendësimin e fjalës "Agrsion" me fjalën "Agjension".

2. Kërkesë e Kryetarit të Komunës për nismën e procedurës së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit.

- ***Propozim vendimi për miratimin e kërkesës – nismës së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzimit me Qytetin Velbert në Gjermani.***
- ***Propozim vendimi për autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për bashkëpunim komunal ndërkombëtar – binjakëzim me Qytetin Velbert në Gjermani.***

z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, sigurisht që kërkesa dhe propozim vendimet përkatëse ju janë dërguar me kohë dhe nuk dëshiroj t'ju lodhi shumë me historikun e kësaj çështje. Ka disa vite që Komuna e Podujevës është në bashkëpunim me Qytetin e Velbert të Gjermanisë, bashkëpunim i cili tani më ka avancuar në një fazë të re dhe në këtë aspekt paralelisht janë filluar procedurat në asamblenë e Qytetit Velbert dhe tani edhe në asamblenë e Komunës së Podujevës me qëllim që ky bashkëpunim të përfundoj me binjakëzim mes dy Qyteteve. Për të vazhduar me procedurat tjera të binjakëzimit kërkohet me legjislacionin në fuqi që Kuvendi i Komunës të miratoj këto dy propozim vendime të cilat ju janë dërguar me materialin përkatës. Pra me ligj kërkohen këto dy faza, bashkëpunim dhe binjakëzim, andaj bashkëpunimin në si Komunë veç e kemi përfunduar kurse tani kërkohet vetëm zhvillimi i proceduarve për binjakëzim, andaj ju ftoj që unanimisht të votohen këto dy propozim vendime në mënyrë që Komuna e Podujevës përfundimisht të binjakëzohet me Qytetin Velbert të Gjermanisë.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e mbështetë kërkesën e Kryetarit të Komunës për nismën e procedurës së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar për binjakëzim mes Komunës së Podujevës dhe Qytetit Velbert në Gjermani. Miratimi i një kërkesë të tillë natyrisht që i hap mundësi bashkëpunimit komunal ndërkombëtar mes qyteteve në fjalë duke besuar dhe shpresuar se ky bashkëpunim do ti sjellë të mira të dyja Qyteteve në përgjithësi. Natyrisht se forma e bashkëpunimit – ndërkombëtarë me binjakëzim është e rregulluar edhe me Ligjin për vetëqeverisje lokale por edhe me Ligjin për bashkëpunim ndër komunal ndërkombëtarë, vlen të theksohet se Komunitat që janë në bashkëpunim ndër-komunal mund të aplikojnë edhe për mbështetje financiare për projekte të rëndësishme tek donatorët ndërkombëtarë përfshirë edhe fondet e Bashkimit Evropian, e që besoj se Komuna e Podujevës do ta shfrytëzoj një gjë të tillë dhe në këtë kontekst është mirë që para propozim projekteve që do t'i kenë Qytetet në fjalë, të konsultohen edhe sektori privat por edhe shoqëria civile, dhe projektet në të cilat do të aplikohet të jenë edhe në bazë të thirrjeve për aplikim por të jenë edhe në interes të qytetarëve të të dyja vendeve. Është shumë e rëndësishme të potencohet se plani i zbatimit dhe mekanizmi i monitorimit të kësaj forme të bashkëpunimit komunal ndërkombëtarë, janë të domosdoshme nëpër të gjitha fazat që kalojnë Komunitat-Qytetet, dhe në këtë pikë do të shtoja që llogaridhënia është pjesë e rëndësishme e çdo marrëveshjeje pasi që Komunitat të cilat hyjnë në bashkëpunime të tilla kanë për obligim që t'i informojnë qytetarët por edhe neve si këshilltarë të Kuvendit për mënyrën, rrjedhën e projekteve dhe formën e bashkëpunimit që do ta zgjedhin. Duke uruar që kjo formë e bashkëpunimit të shkoj mbarë dhe mirë, dëshirojmë suksese dhe punë të mbarë.

z.Fitim Haziri, theksoi, Kryetari i Komunës ka paraqitur një nismë për fillimin e bashkëpunimit mes Komunës Velbert të Gjermanisë dhe Komunës së Podujevës, nismë e cila nuk e solli Kryetarin në Kuvend, i cili e ka harruar Kuvendin prej që ishte nisë si Kryetar i Komunës, kjo nismë që Kryetari nuk po dinë se si me ja nisë sepse kur të pshtjellën punët me të vërtetë se nuk dinë se si me ja nisë. Këtë nismë e mori i pari i Komunës pa paraqitur qëllimin e nismës, çdo nismë duhet të ketë qëllimin, Ligji nr.04/L-010 për bashkëpunim ndër komunal, neni 6 paragrafi 4 thotë, Nisma për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal duhet të përmbajë qëllimin. Nëse qëllimi i Kryetarit është se ky e ka vizituar Qytetin e Velbert me një delegacion nga Komuna dhe këta qenkan pritur ngrohtësisht dhe miqësisht nuk e di se çfarë qëllimi na qenka ky, apo këta qenkan informuar për përvoja dhe praktika të ndryshme sa i përket menaxhimit të institucioneve lokale publike si dhe në fusha të tjera në interes të përgjithshëm, për cilat përvoja dhe praktika po bëhet fjalë neve të paktën nuk na është paraqitur në nismën që e ka marrë Kryetari dhe ne këtë nuk po e dimë. Në këtë Ligj po ashtu thuhet se duhet të paraqiten përfitimet e pritura, çka përfiton Komuna nga ky binjakëzim. Ne si këshilltarë të LVV-së do ta përkrahim këtë nismë sepse besojmë

se është në interes të qytetarëve edhe pse Kryetari nuk ka ditë se qysh me ja nisë për këtë nismë. **z.Fatmir Rudari**, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e përkrahim në parim këtë iniciativë që të fillohet procedura për binjakëzimin e Komunës së Podujevës me Qytetin Velbert të Gjermanisë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, unë e hedh në votim kërkesën – nismën e Kryetarit të Komunës duke përfshirë edhe dy (2) propozim vendimet sipas materialit të dërguar dhe konstatimeve nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua kërkesa e Kryetarit të Komunës për nismën e procedurës së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit, përkatësisht:

- *Propozim vendimi për miratimin e kërkesës – nismës së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzimit me Qytetin Velbert në Gjermani.*
- *Propozim vendimi për autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për bashkëpunim komunal ndërkombëtar – binjakëzim me Qytetin Velbert në Gjermani.*

3. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019 dhe destinim në kategori të caktuara buxhetore.

z.Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019, bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të komunave nga viti fiskal 2018 dhe nga vitet paraprake, të depozituara në Fondin e Republikës së Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një komunë, ndahen për vitin fiskal 2019.

Bartja duhet të behet në projektet e vitit 2018 të cilat kanë qenë pjesë përbërëse e tabelës 4.1 të Ligjit të buxhetit për vitin 2018, mjete të cilat shërbejnë për kryerjen e obligimeve ligjore që rrjedhin nga viti paraprak dhe nuk mund të alokohen në projektet e reja.

Shuma e të hyrave vetanake të realizuara për vitin 2018 është 1,258,530.00 €.

Të hyrat vetanake të bartura nga viti 2017 në vitin 2018 janë 345,787.00 €. Totali i të hyrave të bartura dhe të realizuara janë 1,604,316.00€, të buxhetuara në vitin 2018, kurse shpenzimet e të hyrave për vitin 2018 janë 930,354.00€. Nga kjo del se shuma e mjete që do të barten në vitin 2019 nga të hyrat vetanake është 673,963.00 € dhe të njëjtat propozohen të barten si në vijim: Administratë komunale, që përfshihen të gjitha Drejtoritë, përjashtuar Drejtorinë e Arsimit dhe Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, barten 544,221.31€.

Në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale 60,000.00 €, dhe në Drejtorinë e Arsimit 69,541.61€.

Të nderuar, si pjese përbërëse e propozim vendimit keni të bashkangjitur specifikacionin i cili tregon se në cilin program, në cilin projekt dhe në cilën kategori ekonomike janë orientuar mjetet. Andaj duke pasur parasysh rendësin që këto mjete të jenë në dispozicion për tu shfrytëzuar, kërkojë miratimin e këtij propozim vendimi në mënyrë që të fillohet me implementim e tij sapo i njëjti t'i nënshtrohet procedurave të shqyrtimit të ligjshmërisë.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, më lejoni të paraqesë para jush qëndrimin e Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së lidhur me këtë pikët të rendit të ditës. Jemi në dijeni që një ekonomi të performoj shkëlqyeshëm do të ishte mirë të mos kishte as mungesë dhe as tepëri të mjeteve buxhetore, por ky duket të jetë një koncept më shumë idealist dhe jo pragmatik dhe si i tillë i paarritshëm për tu

zbatuar madje as nga shtetet më të përparuara, prandaj Komunat si njësi buxhetore që janë duke pasë parasysh se bartin mbi supe një numër të madh të projekteve të vogla dhe të mëdha dhe një numër të madh të kontratave ku për zbatimin e të cilave natyrisht që nuk varet vetëm një palë kontraktuese dhe duke marrë parasysh që edhe Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë i Republikës së Kosovës, ua lejon këtë të drejtë Komunave që të bëjnë bartjen e të hyrave vetanake nga viti paraprak në vitin vijues si dhe po ashtu duke shpresuar që trendi i shumës së bartur nga viti në vit të jetë gjithnjë në rënie dhe jo në rritje, natyrisht nga sqarimet e dhëna nga Drejtori i DBF por edhe nga sqarimet shtesë që shpresoj se do t'i japin edhe Drejtorët e Drejtorive tjera përkatëse që preken nga kjo bartje e të hyrave dhe për të siguruar vazhdimësinë e projekteve në të mirë të qytetarëve Llapjan, ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LDK-së japim votën, për, kësaj pike të rendit të ditës, përkatësisht këtij propozim vendimi.

znj.Lirika Maliqi, theksoi, LVV vazhdimisht ka shprehur shqetësimin me keq menaxhimin buxhetor dhe papërgjegjshmërinë e pushteti komunal në realizimin e projekteve dhe në interes të qytetarëve. Përkundër nevojave të mëdha që ka Komuna jonë për investime në të gjitha sferat ne vazhdimisht po përballemi me suficid ku vetëm nga të hyrat vetanake kanë mbetur 673,963.00 €, kurse suficidi buxhetor për vitin 2018 sillet rreth 2 milion euro, para të cilat janë paraparë të investohen për projekte të ndryshme por që kanë mbetur të pashfrytëzuara. Është për tu ardhur keq kur në emisione televizive përqeshni opozitën se gjoja për propozimet që ka opozita, Komuna do të duhej të kishte së paku dyfishin e buxhetit aktual të cilin e ka. Mungesën e profesionalizmit e keni dëshmuar në dështimin për realizimin e buxhetit dhe po ashtu po e dëshmoni edhe në deklarata të tilla. Sa kemi vërejtur në materialin e dërguar, kemi vërejtje rreth projekteve ku janë paraparë bartja e këtyre mjeteve ku shumë prej tyre nuk janë saktësuar. Po bëhet më shumë se një vit nga fillimi i këtij mandati dhe çdo raport financiar dhe çdo dokument që e dërgoni asnjëherë nuk jepni detaje se ku konkretisht barten mjetet, ndonëse një gjë të tillë e kemi kërkuar vazhdimisht, kjo është jo transparente dhe si e tillë nuk ka çfarë të jetë tjetër përveç keq përdorim i buxhetit të Komunës. Jo më kotë të gjitha rrugët e Komunës së Podujevës janë të emërtuara me emra dhe është mirë të filloni t'i përdorni edhe më shumë emrat e rrugëve, përndryshe përderisa vazhdoni të dërgoni raporte me përshkrime jo adekuate të kodeve si *“asfaltimi i disa rrugëve”* ku nuk dihet se cilat janë ato rrugë asnjëherë mos llogaritni në votat e LVV-së sepse asnjëherë nuk do të votojmë diçka që nuk është transparente dhe që ka dyshime për keqpërdorime.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, sa keq me thënë se kanë tepruar rreth 2 milion euro nga viti 2018 kur dihen nevojat dhe kërkesat e shumta të qytetarëve. Paramendojeni që qe dy mandate kërkojmë të ndërtohet një çerdhe në fshatin Lluzhan i cili lidh shumë fshatra përreth dhe që është shumë e nevojshme, një çerdhe për ato nëna të cilat nuk dinë si t'ia bëjnë me fëmijët e tyre. Në debatin me qytetarë kemi ngritur këtë çështje dhe Drejtori i Drejtorisë së Arsimit ka thënë se Çerdhja në Komunën tonë i plotëson nevojat dhe kërkesat për fëmijët parafillorë, por lindë pyetja, si të sjellë ajo nënë fëmijën e saj prej fshatrave në këtë çerdhe të vetme, apo duhet ta merre edhe fëmijën në punë apo më e keqja ta lërë punën krejt. Çerdhe e vetme, pa oborr të rregulluar, pa këndë të lodrave për fëmijë, pa parking për stafin punues dhe prindër, pa kontrolle mjekësore dhe tani më e keqja është se po sa të hapet dera e hyrjes fëmijët rrezikohen se mund të dalin në rrugën e cila është e frekuentuar nga veturat. A e dini se Komunës tonë i mungon një ambient i përshtatshëm ku mund të kalojnë kohën e lirë fëmijët duke luajtur dhe duke u zbavitur pa i obliguar prindërit t'i dërgojnë nëpër restorante dhe në vende të mbyllura të pa ajrosura që iu bëjnë dëme shëndetit të fëmijëve, pra teprojnë mjete dhe këto gjëra nuk rregullohen. Çështja tjetër shqetësuese është fakti se fëmijët Llapjan nuk kanë ku ta shfaqin talentin e tyre e aq më pak se ku të kalojnë kohën e lirë përveç kafiterive. A keni menduar Ekzekutiv se në mungesë të një fotokopjeje, mësimdhënësit

shpenzojnë buxhet për kryerjen e aktiviteteve me nxënësit, pastaj mungesë e kabineteve dhe laboratorëve për lëndë profesionale, mungesë e galerive dhe atileve. A keni menduar të bëni diçka për turizmin në Komunën tonë, pastaj edhe për trashëgimin kulturore të cilën e kemi lënë pas dore për të mos thënë e keni harruar krejt. Pra të nderuar kolegë/e, janë edhe shumë çështje të papërballueshme dhe të realizueshme nëse dinë Ekzekutivi i Komunës të menaxhon parandë publike, pra rreth 2 milion euro të teprojnë dhe qytetarët të presin të realizohen kërkesat e tyre kjo çështje është absurde dhe e papranueshme.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, bartja e të hyrave vetanake është e lejueshme dhe janë të hyra të Komunës të cilat nuk mund t'i merr askush, çështje për të cilën kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-së. Mua më ka brengosë fakti që bartja e të hyrave nga viti 2018 në vitin 2019 në projekte të caktuara janë 673,963.00 €, që i bie rreth 80% e të hyrave vetanake në vitin 2018. Është shumë e logjikshme që të hyrat vetanake të muajit dhjetor të vitit paraprak të barten sepse inkasimi i tyre mund të bëhet deri më 31 dhjetor të atij viti ose mund të themi edhe të hyrat në tre muajt e fundit, e të cilat nuk mund të shfrytëzohen, por të barten të gjitha të hyrat vetanake vjetore dhe të mos shfrytëzohen në atë vit është shumë e pakuptimtë, ose mund të jetë e qëllimtë, ose mos aftësi për me ditë se ku të qoj mjetet, ose është planifikim i rrugëve dhe i punëve pa projekte prioritare dhe të paplanifikuara që duhet të kryhen pagesat, e që për mendimin tim nga kjo situatë del kjo e treta e cila është shumë e vërtetë dhe në këtë aspekt është një element për të cilin me Drejtorin e DBF kemi diskutuar në mbledhjen KPF-së dhe deri në një masë jemi munduar të sqarohemi rreth asaj që u tha se këto mjete barten vetëm në projekte të vitit 2018, jo, kjo është vetëm sa për t'ju gjet vendin mjeteve në mënyrë që të mund të alokohen nga thesari sepse ato mjete të cilat nuk shfrytëzohen, të njëjtat mbeten në thesarin e Ministrisë së Financave. Është shumë e vërtetë se janë shtruar rrugë qoftë me asfalt qoftë me zhavorr por edhe janë filluar rrugë pa kurrfarë planifikimi qoftë buxhetor qoftë urbanistik. Për këto gjëra unë nuk kërkoj llogari direkte vetëm nga Drejtori i DBF sepse për këto përgjegjësi është më e gjerë se sa që mendojmë, por unë po e them që ta merre këtë propozim vendim që e ka sjellë Kryetari i Komunës, t'i merr dokumentet Drejtori i DBF dhe të dalin në vendet ku do t'i bartin dhe shpenzojnë mjetet buxhetore, gjë e cila është shumë e thjeshtë dhe shumë transparente. Bartja e mjeteve është ligjore, por do të ishte morale të barteshin vetëm mjetet vetanake të 2 muajve të fundit të vitit paraprak kur të kesh të gjitha gjërat në rregull dhe nuk ke kurrfarë kërkesash, kurse në sirtarë të DPUMM dhe DSHPMSh ka kërkesa madje edhe 10 vite ku një prej tyre e kam edhe me vete këtu ku qytetarët kanë bërë edhe pagesën e projektit të tyre, kurse askush nuk merret me atë, ndërsa barten rreth 1 milion euro apo komplet të hyrat vetanake të vitit të kaluar mund të them se kjo është pa përgjigje sepse nuk mund t'i ja askush përgjigje por vetëm mund të shtyhem me fjalë këtu. Pra edhe njëherë po e përsërisë, marrim të gjitha dokumentacionet dhe dalim në terren dhe shikojmë se ku do të destinohen këto mjete dhe pastaj e shikojmë se a jeni mirë ju apo ne si opozitë. Nuk mund të thotë askush është mirë kur fillohet në një rrugë dhe shtrohet asfalti pa i paraparë mjetet buxhetore, pastaj çfarë thoni në rast se nuk barten këto mjete sot, ku mbeten ju Drejtor që i keni filluar rrugët në terren dhe janë kryer kurse nuk janë bërë pagesat. U tha se janë projekte dy vjeçare mirëpo edhe për këto projekte duhet të planifikohen mjete buxhetore, mandej fillimisht duhet të përfundojnë projektet prioritare të votuara këtu me shumicë votash, sepse janë projekte prioritare të miratuara në Kuvend dhe disa prej tyre sipas kërkesave të qytetarëve nga debatet publike, mirëpo janë lënë anash projektet prioritare kurse janë filluar projekte të pa planifikuara, madje edhe pa planifikime të subjektit tuaj dhe pse jam në dijeni se ju duhet të punoni me planprogram të subjektit tuaj, por as me një plan të tillë nuk jeni duke punuar, kështu që të rialokohen rreth 700,000.00€ nga viti 2018 në 2019, kurse të anashkalohen të gjitha ato kërkesa dhe nevoja të qytetarëve, mu për këtë qëllim nuk e keni

mbështetjen. Në fakt rialokimi është e drejtë ligjore e Komunave, pastaj janë mjete të cilat edhe po të mos shkojnë në ato projekte nuk mund t'i merr askush dhe mund të barten edhe në vitin 2020, mirëpo vërtetë kjo është një jo profesionalizëm total. Kemi bërë kërkesa të shumta për investime në fusha të ndryshme, por jeni ankuar që nuk kemi mjete buxhetore, por ku i keni pasë këto rreth 700,000.00 €, apo ndoshta tani ju ka rënë ndërmend që i keni këto mjete dhe mund t'i shfrytëzoni, andaj sipas kësaj po del që dikush këtu ka gënjyer sepse nuk e ka treguar të vërtetën duke thënë se nuk kemi mjete buxhetore kurse kjo shumë e të hyrave vetanake të cilat komplet në vitin 2018 kanë qenë në dispozicion qoftë për subvencionim në bujqësi (fermerët, agronomët,) ose për çka do qoftë që dikush ka paraqitur kërkesa, keni thënë se nuk kemi mjete buxhetore. Përse i nderuar Drejtor i DBF nuk keni thënë se i kemi rreth 700,000.00 € dhe të na thoni vetëm paraqitni projektet ne i destinojmë dhe i shpenzojmë, andaj e konsideroj se kjo çështje është më tepër se bastard të diskutojmë për një gjë të tillë.

z.Agron Hyseni, theksoi, bazuar në ndarjen e buxhetit për projektet nëpër fshatra dhe po ashtu planifikimin për bartjen e mjeteve, mendojmë se është bërë në mënyrë jo racionale ku rreth 70% e fshatrave nuk janë të përfshira. Me këtë ndarje që është bërë konstatoj se nuk i kontribuon zhvillimit të komuniteteve dhe përmirësimit të kushteve për qytetarët të cilët jetojnë në ato vende, prandaj shprehë rezervat e mia në lidhje me këtë planifikim dhe e kundërshtoj këtë ndarje të buxhetit i cili edhe me matematikën më të thjeshtë do të ndahej më arsyeshëm.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSh, theksoi, ndoshta do të ishte mirë qysh në fillim të na jepej fjala secilit prej drejtorëve të Drejtorive që është i implikuar në projekte apo çështje që diskutohen me qëllim të dhënies së disa sqarimeve qysh në fillim të kësaj pike sepse janë të nevojshme për këshilltarët e Kuvendit, por megjithatë mbetëm në fund të sqarojmë kërkesat e qytetarëve dhe destinimet e mjeteve buxhetore në projekte të caktuara sipas propozimeve të paraqitura.

Në pika të shkurtra do të jap sqarime rreth bartjes së mjeteve në projekte të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, në infrastrukturë publike janë 86,500.00€, meremetimi i rrugëve me zhavorr, unë e kam një listë të rrugëve të miratuar në vitin e kaluar ku në atë vite janë paguar vetëm 17,000.00€ dhe në këtë vite janë mbi 90% të rrugëve në të cilat do të vazhdojnë investimet dhe është projekt i cili ka qenë dy vjeçar dhe është buxhet i planifikuar nga viti i kaluar, dhe me këtë përmbyllet ky projekt dy vjeçar, do të përmendi disa rrugë të cilat janë të përfshira në këtë projekt; në fshatrat Bërvenik - Lagja Abdullahu rreth 1600 m, Bellopojë – Lagja Dëshiku, në Sylevicë, në Metehi – Lagja Sinani rreth 800 m, në Barainë – Lagja Rama rreth 700 m, në Gërdoc – Lagja Dulovit rreth 900 m, në Sallabajë – Lagja Mustafa tek Varrezat rreth 800 m, pastaj në Orllan, Rakinicë etj, pra janë mbi 35 rrugë/rrugica të cilat do të keni mundësi t'i shihni investimet në çdo raport 3 mujor që do të jepet në Kuvend. Tek punët e parterit – ndërtimi dhe riparimi i urave, janë disa punë të cilat kanë mbet të papërfunduara siç është ura në fshatin Pollatë ku kemi pasë probleme pronësore dhe mos marrëveshje mes banorëve, pastaj është ura në afërsi të shkollës “Xheladin Rekalu” urë e cila duhet të rindërtohet sepse ka të bëjë me sigurinë e nxënësve dhe do të filloj shumë shpejt, mandej kemi urën në fshatin Lupç të Poshtëm ku ka mbet përforcimi i saj, kemi edhe planifikimet tjera në fshatrat Bajçinë – Letanc te Lagja Gjata, pastaj ura në Sekiraçë, dhe posaçërisht kemi edhe një urë për të cilën ndoshta na nevojitet edhe buxhet shtesë, fjala është për urën në Orllan – mbi Liqenin, urë e cila është e ngushtë dhe ka një gjatësi të konsiderueshme andaj planifikojmë t'ia ndërtojmë edhe një aneks me qëllim të sigurisë së nxënësve. Pastaj kemi shumë prej 26,570.00 € të cilat propozohen të barten në shërbimet e zjarrfikësve kryesisht tek punët e parterit gjegjësisht rregullimin e oborrit, rrethojës etj, ku vitin e kaluar është bërë hapja dhe disa rregullimi tjera kurse këtë vite përfundon projekti. Të gjitha këto projekte, mbi 95% në vitin e kaluar kanë qenë të planifikuara nga të hyrat vetanake dhe suficiidi

nga këto projekte në vitin e kaluar është më pak se 5% ngase DSHPMSh ka arritur implementimin e buxhetit rreth 95% të investimeve kapitale, çështje e cila sigurisht që do të diskutohet në raportin financiar në mbledhjen e ardhshme.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, desha të sqaroj atë që e tha këshilltari z.Rafet Llapashtica se nuk ka pasë projekte, e vërteta është se ka pas projekte dhe kanë qenë të planifikuara me buxhet të caktuar por për shkak të kohës disa prej tyre nuk ka mund të realizohen dhe si rrjedhojë ne nuk kemi dashtë dhe as nuk mundemi të bëjmë pagesa pa kryerjen e punëve. Pra janë 5-6 projekte të cilat figurojnë edhe në materialin e propozuar, thuhet disa rrugë, si; në fshatin Buricë më saktësisht mes Penuhës dhe Buricës është një rrugë jashtëzakonisht në gjendje të keqe nëpër të cilën janë rreth 85 nxënës të cilët kalojnë andej, rrugë e cila ka qenë në projekt dhe është bërë pagesa prej 18,775.76€, kurse kanë mbet 63,198.00€ pagesë e cila duhet të bëhet në këtë vit respektivisht që të vazhdoj projekti në këtë vit. Projekt tjetër kemi gjelbërimin në Podujevë, jemi në dijeni se kemi dy gjelbërime në Podujevë për të cilat edhe qytetarët kanë dhënë sugjerime shumë të mira, pastaj kemi dy shkolla të cilat janë në gjendje jo të mirë, Gjimnazi ‘Aleksander Xhuvani’ dhe shkolla ‘Enver Maloku’ të cilat janë propozuar të rregullohen me gjelbërim dhe kemi ndarë-propozuar shumën prej 59,380.00€, ndërsa projekti tjetër është në fshatin Dobratin dhe është me një kontratë dy vjeçare por që ka mungesë një shumë prej 22,500.00€ me të cilën duhet të plotësohet për shkak se është planifikuar nga të hyrat vetanake. Pastaj në fshatin Siboc kemi një pagesë e cila të kryer në shumë 15,865.00€ kurse ka mungesë prej 14,009.97€, shumë e cila duhet të plotësohet këtë vit për asfaltimin e rrugës e cila nuk është asfaltuar në vitin e kaluar për shkak se nuk ka pasë kushte dhe ka qenë jashtë standardeve, andaj nuk kemi dashtë të asfaltojmë në atë kohë por kemi lënë që të asfaltohet në fillim të këtij viti. Gjithashtu të njëjtën situatë e kemi edhe te fshati Godishnjak ku është bërë një pagesë prej 22,092.00€ kurse kanë mbet të barten edhe 35,713.26€ dhe të përfundoj ai projekt sepse kontrata ka qenë ashtu. Mandej kemi projektet në fshatrat Majac dhe Dobërdol, që janë të Ministrisë përkatëse por që ne kemi pasë një buxhet vetanak dhe kemi bërë një pjesë të pagesës nga Ministria dhe tani po ajo Ministri e ka plotësuar buxhetin dhe ne jemi të gatshëm të shpenzojmë pjesën tonë. Nëpër qytet do të jenë disa rrugë të cilat ne nuk i kemi asfaltuar për shkak se nuk ka pas standardë për një gjë të tillë, dhe tani kemi një buxhet shtesë dhe planifikojmë të përfundojmë, si dhe kemi zgjerimin e rrugës ‘Zahir Pajaziti’, rrugë në të cilën kemi pas jashtëzakonisht probleme të mëdha, sidomos sa i përket energjisë elektrike ku kanë qenë 3 kablllo 10 KW të shtrira nën rrugë dhe nuk ka dituar askush ku gjendet rryma, dhe kemi pas 5 shkëputje të energjisë elektrike, dhe për këtë e them se është një fat i mirë që nuk ka pasur lëndime apo humbje të jetëve të njerëzve si pasoj e atyre kablllove, andaj këtu kemi buxhete shtesë prej 87,905.00€ që e kemi propozuar me qëllim që të filloj vazhdimi i projekteve. Pra këto janë mjete të cilat nuk janë paguar kompanive në vitin e kaluar ngase nuk janë kryer të gjitha punët, por presim që të miratohet kjo bartje dhe të vazhdojmë me ato projekte.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse nuk të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës dhe rekomandimit të komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 16 vota për, 17 vota kundër, dhe asnjë votë e përmbajtur, nuk miratohet propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 në vitin 2019 dhe destinim në kategori të caktuara buxhetore.

4. Propozim Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB për vitin 2019

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSh, në cilësinë e koordinatorit të KKSB-së, e paraqiti fjalën hyrëse përkatësisht propozim planin e punës së KKSB-së për vitin 2019, ndër të tjera theksoi, propozim plani në fjalë ju është dërguar me kohë dhe besoj se të gjithë e keni lexuar dhe analizuar, mirëpo mirëpres ndonjë propozim konkret dhe të arsyeshëm nga ana e këshilltarëve të Kuvendit në mënyrë që Plani të pasurohet edhe më shumë me tema dhe çështje tjera. Ky plan ndryshon nga viti i kaluar, duke pas parasysh edhe ndryshimit të mandatit të FSK-së ku ne jemi pjesë të Batalionit të tretë, është paraparë një informatë për gjendjen e sigurisë, ndërsa temat tjera janë kryesisht të përgjithësuara dhe që ne i kemi vlerësuar se janë të dobishme për diskutim herë pas herë, mirëpo kanë të drejtë që të parashihen edhe tema të reja që mund të futen qoftë nga Kuvendi, qoftë nga Kryetari i Komunës. Edhe njëherë e përsëris që nëse ka tema – pika të rëndësishme dhe të arsyeshme që nuk janë paraparë, e mirëpresim të përfshihet në kuadër të këtij propozim plani.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e konsideron të nevojshëm Planin e punës së KKSB-së për vitin 2019, në radhë të parë për ne si këshilltarë të Kuvendit dhe po ashtu për qytetarët në përgjithësi. KKSB në këtë propozim ka pasqyruar një varg aktivitete me rëndësi lidhur me sigurinë në bashkësi, aktivitete të cilat si të tilla krijojnë një mobilizim të Ekzekutivit të Komunës, Organeve të rendit, Shoqërisë civile, Komunitet fetar, etj, si dhe qytetarëve në përgjithësi në mënyrë që situatat të cilat mund të paraqiten gjatë këtij viti të menaxhohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Përveç këtyre aktiviteteve, plani në fjalë mund të pasurohet edhe me propozime konkrete në funksion të menaxhimit sa më të mirë të situatave që mund të paraqiten dhe në të njëjtën kohë ju mbetet që organet përgjegjëse për siguri në bashkësi të jenë në nivel të detyrës dhe përgjegjësisë që kanë. Në këtë kuptim, ne si Grup i këshilltarëve të LDK-së kemi 3 sugjerime lidhur me këtë plan të punës së KKSB-së, dhe atë; 1-në të ardhmen në kuadër të planit të punës të përfshihen edhe projekte konkrete vetëdijesuese lidhur me dukurit negative në shoqëri dhe nëse këto, dhe nëse këto kanë kosto financiare të pasqyrohen në plan të punës ashtu siç ekzistojnë edhe në planet e natyrave të tjera, 2-koordinimi edhe më i madh mes akterve relevant për krijimin e sigurisë në bashkësi, dhe kur e themi këtë kemi parasysh faktin që shpesh herë janë trajtuar çështja e zjarreve, çështja e vjedhjeve dukuri e cila nga viti 2014 nuk ka qenë e manifestuar shumë në Komunën tonë por që për fat të keq ka filluar të shfaqet, dhe mendojmë se në rekomandimet e juaja si KKSB është mirë të përcillen tutje edhe nga akterët tjerë relevant, fjala është për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit i cili është mirë t'i informojë drejtorët e shkollave mbi një gjendje të caktuar shembull, vjedhjeve ose zjarreve ku pastaj drejtorët e shkollave janë të obliguar t'i informojnë këshillin e prindërve dhe këshillin e nxënësve, gjithashtu edhe komunitete fetar përmes kolegëve të tyre dhe formave të diskutimit që kanë t'i manifestojnë edhe tek kolegët e tyre në mënyrë që situata për një çështje të caktuar të sensibilizohet në mënyrën më të mirë të mundshme, dhe 3-ne mendojmë se njoftimet e takimeve të KKSB-së por edhe njoftimet që janë me rëndësi për Komunën e Podujevës duke përfshirë edhe buxhetin dhe shumë pika tjera është e domosdoshme të sponsorizohen, kur e them këtë kemi parasysh zyrtarët e Teknologjisë Informatike dhe ata të Zyrës për Informim, opsionin e faqes së facebook-ut të Komunës së Podujevës ta bëjnë me pagesë përmes sponsorizonit në mënyrë që të njoftohen sa më shumë qytetarët për aktivitete vetëdijesuese rreth sigurisë në bashkësi. Për fund urojmë që KKSB të ketë punë të mbarë gjatë vitit 2019.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, më datën 19 shkurt 2019 është mbajtur mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi ku është miratuar plani i punës për vitin 2019, por ndër tjerash është theksuar se gjendja e sigurisë në Komunën e Podujevës është e qetë dhe stabile. Pra ky Këshill i Komunës

tonë punon sa për sy e faqe dhe sa për të marrë mëditje, e jo për të treguar se punon për të siguruar qytetarët. A jeni në dijeni se para disa muajve u vra një i ri në hekurudhën e fshatit Surkish dhe ende nuk është zbardhur rasti, thuhet se ka siguri të plotë kurse në fshatin Dumosh janë djegur dy lopë. Kanë kaluar vetëm dy muaj nga fillimi i vitit 2019 dhe Komuna e Podujevës dhe qytetarët e saj janë dëshmitarë të aksidenteve në komunikacion me fatalitet, pastaj me grabitje të armatosura dhe me therje me thikë. Në shkollat tona, sidomos në ato të mesme, çështja e sigurisë së nxënësve është në nivelin më të ulët të mundshëm pasi që Policia nuk është në rolin e duhur për të kryer shërbimin e sigurisë ndaj nxënësve, duke luftuar rreziqet dhe armëmbajtjet nga nxënësit. A mund të thuhet se ka siguri kur asgjë nuk ndërmerret për qentë endacak ku si rast konkret kemi kur qytetarët shkojnë për të kërkuar shërbime shëndetësore por në oborrin e shtëpisë së shëndetit ka grumbull të qenve endacak që paraqesin rrezik permanent për qytetarët. Pastaj ku mund të thuhet se ka siguri kur asgjë nuk ndërmerret për personat me çrregullime mendore që bredhin rrugëve pa kurrfarë mbikëqyrje. Pastaj në zonat kufitare zhveshja e pyjeve nga prerja e drunjtëve në mënyrë ilegale, çështja e sigurisë së nxënësve në mungesë të nënkalimeve dhe trotuareve sidomos tani me zgjerimin e rrugës, mungesë e hapësirës së lirë të qytetarëve në trotuare si pasojë e parkimit të veturave nga qytetarët në kundërshtim me rregullat. Pra ne si Grup i LVV-së propozojmë që ky Këshill të punoj për të mirën e qytetarëve, që qytetarët të kenë një siguri më të mirë në komunikacion, të mos ndodhin vrasje enigmatike, të zgjidhet problemi me qentë endacak si dhe të vendosen kamerat e sigurisë në oborret e shkollave e sidomos në shkollat e mesme në mënyrë që të përcillet siguria e nxënësve. Ne kërkojmë që në seancën e radhës të jetë prezent Komandanti i Stacionit të Policisë dhe të raportoj para nesh për sigurinë e vendit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, propozim plani i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019 është mirë që është sjellë në muajin mars tani. Ky propozim plan rreth 80% përflitet vetëm për pyjet dhe zjarret në pyje si fenomen i rrezikut. Besoj se nuk janë fenomenet preventive të cilat duhet të shihen si akteri kryesor i rrezikut në shoqëri. Si fenomene të cilat kemi mund t'i vërejmë në vitin që lëmë pas por edhe në dy muajt që shkuan të këtij viti, ka qenë fenomeni i plaçkitjeve dhe fenomeni i rrezikshmërisë së nxënësve në shkollat e Komunës së Podujevës. Ka pas një varg plaçkitjesh nëpër institucione qoftë financiare por edhe nëpër shtëpi private, plaçkitje të dhunshme dhe të armatosura si dhe pasiguri në shkolla me therje të nxënësve, rrahje të nxënësve dhe profesorëve, kurse me këtë dokument për vitin 2019 askush nuk e ka parë si preventivë kryesore. Duke qenë të kënaqur me vetëdijsimin e qytetarëve për mos futjen e tyre si ekstremi kryesor i terrorizmit që bëhet dhe që na preokupon, i falënderojmë të gjitha institucionet dhe të gjithë qytetarët që ne si Komunë e Podujevës qëndrojmë më së miri në këtë drejtim dhe njëkohësisht i gëzohem këtij fakti, mirëpo mendoj se Komuna e Podujevës, Kryetari i KKS-së që është edhe Kryetar i Komunës së bashku me gjithë akterët tjerë duhet që t'i përforcojnë planet e tyre në dy shtyllat e cekura në mënyrë që t'i jepet përgjigje situatës, e që mendoj se i pari që duhet të jep përgjigje situatës është ai i cili është në krye të situatës. Përgjigje situatës për gjendjen e sigurisë në shkolla duhet t'i jap dikush, duhet t'i jep Kryetari i Komunës, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Komandanti i Stacionit të Policisë, jemi në dijeni se akteri KFOR nuk është për ruajtjen e rendit publik sepse është në kuadër të NATO-s dhe kujdeset për vijat kufitare, kurse për rendin publik pas shpalljes së Pavarësisë përgjegjëse janë organet e shtetit të Republikës së Kosovës, dua të them se kemi organet tona si shtet që janë Policia e Kosovës dhe organet tjera të cilat i përgjigjen situatave, mirëpo ende nuk i ka dhënë përgjigje situatës askush për këto fenomene që i ceka, por besoj se Policia janë duke u marrë me rastet sepse plaçkitjet nëpër shtëpi janë të rënda dhe ata njerëz që plaçkitin duhet të ulen në karriget që meritojnë. Pastaj edhe prindërit që dërgojnë fëmijët e tyre në shkolla, duhet të shohin se ata që shkojnë me armë të ftohta ose të nxehta në shkolla apo ata që sillen si rrugaç dhe i cili shet mend 100 mijë qytetarëve,

duhet të shohin se ku e kanë vendin e tyre, dhe kësaj situate duhet t'i jap përgjigje dikush natyrisht me kërkesën e Kryetarit të Komunës, sepse nuk guxon të ndodh që rreth shkollave të sillen vetura dhe të bëjnë filma aksion, e them kështu, dhe këtë duhet ta ndërpres dikush madje mendoj se edhe Drejtori i Drejtorisë së Arsimit duhet të vizitoj nganjëherë shkollat dhe të shikoj çfarë po ndodh dhe të ndërmerrni masa bashkërisht me Kryetarin e Komunës që të paktën pushimet e shkurtra që janë gjatë orarit mësimorë të bëjnë brenda hapësirave të shkollave e jo të sillen dhe të sorollatën rrugëve dhe të lejohet të hyjë çdo kush në hapësira shkollore. Andaj sa i përket Planit, ne në një mënyrë nuk kem qare pa miratuar një Plan të tillë, mandej i mbështesë edhe rekomandimet e dhëna nga z.Avni Fetahu. Por si do që të jetë ky plan i cili për çdo vit sjellët kështu me pak a hiq ndryshime, ne në mënyrë formale i japim mbështetje, mirëpo në mënyrë njerëzore dhe morale po kërkoj që edhe pasi të miratohet si i tillë kështu ky plan, KKSB të marrë parasysh propozimet dhe këshillat e secilit duke përfshirë edhe preventivat e secilit në funksion të ruajtjes së sigurisë sepse janë gjëra të cilat nuk bënë të ndodhin, dhe që mund të parandalohen, kur e them këtë e kam parasysh që po ndodh shpesh që po ka therje në hapësirat ose afër shollave të Podujevës, andaj ata nxënës duhet të largohen nga aty ose t'ju ndërrohet shkolla. Pastaj nuk guxojmë si institucion që jemi të lejojmë që prindërit të shkojnë në shkolla dhe në një formë të sjellin ligje në shkolla, kush do qofshin ata.

Pra e mbështesim këtë dokument, por mendojmë se është mirë të ndërmerren masa në funksion të parandalimit të disa situatave që ndodhin sidomos në shkolla dhe në vende tjera publike, mirëpo besoj se do të merren parasysh edhe rekomandimet, sugjerimet dhe vërejtjet tona dhe të gjithsecilit, me qëllim që të kemi një siguri më të plotë për të gjithë.

z.Agim Behluli, theksoi, meqë po diskutohet për sigurinë unë dëshiroj të mbrojë komunitetin e biznesit të cilit edhe i takoj, fjala është për një plaçkitje në një pompë të derivateve, rast i cili nuk është shumë larg që ka ndodh, situatë kjo e cila ka ndikuar drejtpërsëdrejti tek ne sepse na është dashtë të rrisim numrin e punëtorëve – rojtarë. Me të vërtetë kemi problem në këtë aspekt, këtu asnjëherë nuk e kam parë Komandantin e Stacionit të Policisë të vije në Kuvend e që do të dëshiroja të vinte, ose të paktën të na pyes ndokush neve si biznese sa i përket aspektit të sigurisë.

Kam një propozim, do të ishte mirë që nga dy këshilltarët të Kuvendit nga secili subjekt politikë të formohej një grup i cili pastaj do të vizitonte shkollat dhe të merrej me shkollat sa i përket qëndrimit në shkolla të nxënësve dhe mësimdhënësve, situatën në hapësira dhe jashtë shkollave etj. Po ashtu do të ishte mirë të inspektoheshin edhe lokalet rreth shkollave se çfarë shesin në ato lokale, mos rastësisht ndodh të shesin diçka që nuk është e mirë për fëmijët tanë.

Gjithashtu kam propozim edhe sa i përket çështjes së bizneseve që kanë probleme me sigurinë, ndoshta është jashtë kësaj teme që po diskutojmë por do të ishte mirë të caktohej një orar i kafiterive në qytet se deri kur mund të qëndrojnë të hapura ato, kjo me qëllim që të vihet në kontroll dhe t'i kontribuon sigurisë. Mirëpo sërish e ceku se problemi kryesor qëndron tek shkollat, e që mund të them, ose mua më duket ashtu, se kemi humb kontrollin mbi shkollat dhe një gjendje të tillë mund ta vërejmë nëse veç kalojmë nga shkolla ekonomike këtu në qytet shohim shumë persona për të cilët nuk dimë a janë nxënës apo kush janë, madje shihen edhe policë që sjellën andej por si duket edhe këta të fundit po shoqërohen nëpër kafe me ata persona, kurse më vonë shihen diku tjetër, andaj është mirë që sa më parë të merren masa sa nuk është bërë vonë.

z.Faik Muçiqi, Drejtor i DSHPMSh, dhe koordinator i KKSB-së, theksoi, falënderoj të gjithë për kontributin në këtë draft dokument të planit të punës së KKSB-së. Disa prej temave të parapara mund të them se janë në përgjithësuara siç është tema për sigurinë në shkolla për të cilën dy herë me plotë të drejtë e theksuat si problematike, por që është paraparë në plan me akterët, Drejtori e Arsimit dhe Stacioni i Policisë. Gjithashtu sa i përket vjedhjeve ka qenë aktuale edhe në vitin e kaluar dhe për këtë çështje në seancën e radhës sigurisht se do të përgatitet raporti i punës së KKSB-

së për vitin 2018 dhe do të mund të shihni aktivitetet dhe masat e ndërmarra rreth këtyre çështjeve përkatësisht tek raportet e Policisë trajtohen të gjitha. Meqë pash vullnetin e shumicës që ky draft Plan i punesa të miratohet, ne sigurisht që do të kemi parasysh që në raste të caktuara mund të përfshihet edhe ndonjë temë e propozuar – sugjeruar nga ana e Kuvendit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj të gjithë për kontributin, mendoj se të gjitha këto sugjerime dhe vërejtje të dhëna rreth shtimit të vigjilencës dhe rritjes së sigurisë në Komunën e Podujevës, t'iu behet thirrje të gjithë mekanizmave dhe organeve të ndryshme përgjegjëse për sigurinë qoftë në shkolla, qoftë në aspekte tjera të jenë të angazhuar maksimalisht. Unë besoj se Komandanti i Stacionit të Policisë ka gatishmërinë por edhe detyrë dhe obligim që kohë pas kohe të na informoj rreth gjendjes së sigurisë së përgjithshme në territorin e Komunës së Podujevës andaj besoj se kur do që e ftojme ai do të jetë i gatshëm për një gjë të tillë.

Meqë nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, unë e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri miratohet propozim Plani i punës së KKS-së për vitin 2019, sipas materialit përkatës.

5. Propozim vendimi për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër Kompanisë Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, para vetës keni propozim vendimin e Kryetarit të Komunës për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës dhe pronave shoqërore – rrugë publike lokale, në shfrytëzim afat shkurtër KEDS-it, kompani e cila në vazhdim të investimeve për vitin 2019 ka paraparë një shumë prej 6.5 milion euro për rregullimin dhe zgjerimin e rrjetit elektroenergetik dhe vendosjen e trafave të reja në territorin e Komunës së Podujevës. Në këtë aspekt, KEDS vazhdon t'i drejtohet me kërkesa zyrtare DPKGJ dhe DPUMM për vendosjen e trafave të reja, dhe në periudhën nga 21 dhjetor 2018 deri më 14 shkurt 2019 nga KEDS kanë arritur 6 kërkesa për vendosjen e 24 trafave shtyllë, të cilat do të vendosen në parcelat, dokumentacionin e të cilave i keni në materialet e dërguara, ku propozohet t'i jepen nga 9 m² nga parcelat përkatëse, tri trafo blind të cilat do të vendosen në pjesët përkatëse të pronave përkatëse në sipërfaqe prej 20 m², 25 m² dhe 30 m² sepse janë madhësi të ndryshme të atyre trafave blind. Këto trafo KEDS, ka planifikuar t'i vendos në prona shoqërore – rrugë publike dhe dy prej tyre në prona të Komunës në lokalitetet siç janë në materialin e propozim vendimit *(në vazhdim Drejtori paraqet secilën pjesë të parcelës që propozohet për dhënie në shfrytëzim sipas propozim vendimit)*.

Këto pjesë të pronave është propozuar t'i jepen në shfrytëzim KEDS-it për një periudhë kohore 15 vite, pa pagesë me të vetmin qëllim që qytetarëve nëpër lokalitete të ndryshme t'ju rregullohet cilësia e energjisë elektrike.

Në mbledhjen e KPF-së nga shefi i Grupit të LVV-së kemi pasë vërejtje pse këto prona jepen pa pagesë, mirëpo unë kërkoj nga ai që të sjellë vetëm një vendim të ndonjë Komune që i ka dhënë prona në shfrytëzim me pagesë KEDS-it.

Vlen të theksohet se dhënia e pronave të Komunës në shfrytëzim parashihet në Ligjin përkatës, neni 5.2 shprehimisht përcaktohet mundësia e dhënies me apo pa pagesë.

z.Avni Fetahu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim sipas materialit të dërguar, propozim për të cilin jemi konsultuar edhe me Drejtorin e Drejtorisë përkatëse dhe na janë dhënë argumente të mjaftueshme që Ligji e mundëson pa pagesë

dhënien e pronave në shfrytëzim, për qëllime në interes të qytetarëve dhe interes të përgjithshëm të Komunës.

z.Fitim Haziri, theksoi, është e vërtetë se qëndrimi i subjektit LVV për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale kompanisë private KEDS, pa pagesë, ka qenë gjithherë kundër dhe arsyetimet jepen që KEDS po investon në Komunën e Podujevës me shuma milionëshe në shtrirjen e rrjetit energjetik dhe trafostacione të ndryshme, por ju po harroni se KEDS nuk është duke e favorizuar Komunën e Podujevës pse ne po i japim prona publike në shfrytëzim, pa kompensim. Kjo kompani ka marrë obligim që të shtrijë rrjetin në tërë Republikën e Kosovës, pra është e obligueshme dhe meqë është kështu ajo Kompani nuk ka qare pa e shtri rrjetin. Sa i përket asaj që Drejtori parafolës e tha se parashihet me ligj që një pronë të jepet në shfrytëzim pa kompensim kur kemi të bëjmë me interesin e qytetarëve të Komunës, mirëpo edhe nëse nuk e ka bërë asnjë Komunë një gjë të tillë, përse mos të jemi ne të parët që e iniciojmë çështjen e kompensimit. Këto prona që po i jepen KEDS-it për vendosjen e shtyllave elektrike, Kompania KEDS nga kompanitë kabllore që veprojnë në Komunën e Podujevës, në çdo shtyllë që lidhen këto Kompani kabllore e ka 1 € që merr prej tyre, atëherë përse po u dashka që KEDS të përfitoj prej lokacioneve që ne u a japim atyre kurse ne si Komunë nuk bënë të përfitojmë. Andaj nëse mund të na tregoni se çfarë favor ka bërë KEDS Komunës së Podujevës. Është fakt që Komuna e Podujevës paguan për ndriçim publik, atëherë përse ne të mos kërkojmë prej KEDS-it që në lokacione të caktuara Komuna të mos ngarkohet me faturimin e energjisë elektrike, kemi shumë vende, ta zëmë ku janë Dëshmorët e Kombit etj, andaj përse të mos kërkojmë që të paktën ato lokacione të mos faturohen.

Pra këto janë arsyet që ne jemi kundër propozim vendimeve të tilla, përderisa nuk ndryshohet neni 4 i propozim vendimit tuaj, dhe të çeket se në lokacionet në fjalë, KEDS ta liroj nga pagesa Komunën e Podujevës.

z.Bashkim Sylja, theksoi, neve si Kuvend i Komunës po na kërkohet t'i japim në shfrytëzim pronë shoqërore – rrugë publike lokale dhe pronë komunale. Në vitet e kaluar ne kërkesat e KEDS i kemi miratuar duke menduar gjithmonë në ngritjen e shërbimit ndaj konsumatorëve, mirëpo duke parë gjendjen në terren dhe ankesat e qytetarëve ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së do të votojmë kundër këtij propozim vendimi, dhe arsyeja kryesore është vendosja e orëve elektrike lartë në shtylla elektrike, por kemi edhe vërejtje tjera siç është diskriminimi i disa prej konsumatorëve ku dikujt i futet kablloja nën dhe, dikujt i dërgohet me shtylla elektrike, vendosja e shtyllave afër rrugëve e që paraqesin pengesa edhe për këmbësorët, kështu që ne do të votojmë kundër këtij propozim vendimi.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, theksoi, sa për sqarim, më shtyri të marr fjalën parafolësi i cili u deklarua në emër të Grupit të këshilltarëve që i takon, unë vetëm një gjë po e çekë ngase sa më duket i kemi ngatërruar kompetencat paksa ngase e dinë shumë mirë edhe shefi i Grupit të PDK-së që ne në të kaluarën kemi qenë që pronat në fjalë të jepen me pagesë Kompanisë në fjalë dhe kemi marrë vendime, mirëpo na janë kthyer mbrapsht të gjitha ato vendime dhe jemi detyruar t'i anulojmë ato vendime dhe të nxjerrim të tjera duke hequr nenin ku ishte paraparë kompensimi. Unë paraprakisht kërkoja nga shefi i Grupit të LVV-së që të na sjell ai ndonjë vendim ku parashihet kompensimi për një gjë të tillë, qoftë edhe nga ndonjë Komunë e cila udhëhiqet nga LVV, ne po e pranojmë si të tillë. Andaj mos të veprojmë në dëm të askujt sepse me rrjetin e ri të energjisë elektrike rritet edhe cilësia e standardit të jetesës së qytetarëve, shembull kemi fshatin Batllavë të cilët e kanë pasur energjinë elektrike si po të ishte llamp vajguri, kurse tani çfarë cilësi të energjisë ka ai fshat. Ne në asnjë mënyrë nuk po e favorizojmë KEDS-in por mendoj se është mirë t'i lëmë të investojnë në territorin e Komunës së Podujevës, gjë për të cilën nga disa Komuna ka pas edhe reagime përse nuk po investon KEDS në ato Komuna, siç është ajo e Drenasit. Është fakt që është përmend se KEDS e ka për

obligim të investoj, mirëpo më mirë është të investohet tani se pas 5 viteve sepse efekti i humb dikur. Andaj të mos shkohet vetëm me logjiken e votimit kundër ngase vet shefi i Grupit të PDK në mandatin e kaluar ka qen ai që ka kërkuar kompensim të tillë dhe jemi dakorduar të gjithë dhe është marrë vendim sipas të cilit është caktuar shuma prej 10 euro qira mujore për trafo, vendim i cili na është refuzuar.

Sa i përket çështjes që u tha se KEDS jua merr nga 1 euro kompanive tjera kablllore, për shfrytëzimin e shtyllave, unë tani po e dëgjoj dhe nuk kam kurrfarë informatash të tilla.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë propozim vendim duke përfshirë edhe rekomandimet nga mbledhja e KPF-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 18 vota për (duke përfshirë votën e dyfishtë të Kryesuesit, që ishte, për), 17 vota kundër, miratohet propozim vendimi për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër Kompanisë Kosovare për Distributim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS, sipas materialit përkatës, dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, mendoj se është mirë të konstatohet nga Kryesuesi i Kuvendit çdo procedurë e votimit, përkatësisht çdo rezultat, kaloj apo nuk kaloj propozimi. E them këtë sepse po ky rezultat paraprak (17 për, 17 kundër) ishte edhe në rastin votimit për pikën 3, por që ishte një gabim teknik në numërim dhe doli si rezultat 16 për, 17 kundër, andaj të keni kujdes.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, unë shumë mirë e konstatova si tani si në pikën 3 të rendit të ditës, por ju që bisedoni tërë kohën mes vete dhe nuk dëgjoni, nuk kam çfarë të bëjë, prandaj sugjeroj t'i lëni bisedat dhe të jeni më të vëmendshëm.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i drejtohem Nënkryetarit të Komunës, pa dashur të diskutojmë më gjatë dhe të lihet vend për dilema, nuk është ashtu si e potencoj ai rreth votimit të pikës 3, sepse saktësisht votat ishin: 17 kundër (LVV 8 vota, PDK 6 vota kundër, AAK 2 vota kundër, PSD 1 votë kundër, LDK 1 votë kundër), pra matematik e thjesht është kjo, andaj të mos thuhet, nuk ishte ashtu, sepse ashtu ishte.

6. Informatë e Drejtorisë së Kulturës Rinis dhe Sportit rreth; -Aktiviteteve të DKRS-së gjatë vitit 2018 dhe mbështetjet-përkrahjet buxhetore për shoqata të ndryshme joqeveritare dhe klubet sportive, -Bibliotekës së Qytetit, si dhe -Klubit të Futbollit Llapi – Podujevë.

znj.Donika Sfishta, Drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit – DKRS, e paraqiti fjalën hyrëse, përkatësisht Informatën e kërkuar. Theksoi, më lejoni që para jush të paraqesë informatat përkatëse rreth aktiviteteve të DKRS, përkatësisht rreth -aktiviteteve të DKRS-së gjatë vitit 2018 dhe mbështetjet-përkrahjet buxhetore për shoqata të ndryshme joqeveritare dhe klubet sportive, pastaj për Bibliotekën e Qytetit si dhe informatën për Klubit të Futbollit Llapi – Podujevë.

Gjatë vitit 2018 DKRS ka pasë aktivitete të ndryshme sa i përket Kulturës Rinisë dhe Sporti në territorin e Komunës së Podujevës ku të gjitha mund të vlerësohen se kanë qenë të suksesshme. Gjithashtu DKRS gjatë vitit 2018 ka subvencionuar një numër të madh të OJQ-ve (të gjitha që kanë shprehë interesim dhe kanë aplikuar) për aktivitete të ndryshme të parapara sipas plan programeve të paraqitura përmes shpalljeve-thirrjeve publike për subvencionim, dua të them se janë bërë dy thirrje

publike bazuar në rregulloren përkatës të Ministrisë së Financave ku janë subvencionuar të gjitha klubet sportive dhe të gjitha OJQ-të që kanë aplikuar, andaj për më shumë detaje bashkëngjitur në materialin e dërguar keni edhe listat.

Sa i përket Bibliotekës së Qytetit jeni në dijeni se nga Komuna e Podujevës ka qenë e planifikuar që rruga në drejtim të Xhamisë së qytetit të zgjerohet, respektivisht të ndërtohet rrugë e re me standarde të reja. Në këtë aspekt gjatë vitit 2018 janë zhvilluar procedurat dhe është filluar me projektin në fjalë sipas të cilit është paraparë edhe rrënimi i objektit të vjetër (ish Komiteti) në të cilin për disa vite ka qenë e vendosur Biblioteka e qytetit. Fillimisht planifikimet kanë qenë që pas zhvendosjes në objektin e ri të Komunës, Biblioteka të bartet në objektin e tanishëm të Komunës, por meqë në objektin e ri ka pas disa vonesa rreth përfundimit të punimeve, respektivisht pranimi të punimeve dhe objektit në fjalë, kemi mbete në këtë gjendje që jemi edhe tani. Ju informoj se e gjithë literatura/tekstet që kanë qenë në kuadër të Bibliotekës së qytetit përkohësisht janë deponuar në sallën e sportit të shkollës së mesme "Fan S. Noli" ku edhe ende qëndrojnë, mirëpo pavarësisht kësaj biblioteka ka vazhduar të pasurohet me fondin e librit përmes autorëve dhe donatorëve, si dhe lexueseve të interesuar ju është dhënë mundësia që përmes DKRS-së (zyrtarëve përkatës) të furnizohen me literaturën ose tekstet e kërkuara. Vlen të theksohet se fondi i bibliotekës prej 40000 ekzemplarë dhe mbi 11860 tituj kërkon minimum 200m² hapësirë për vendosjen e tyre, duke pas parasysh edhe kushtet në të cilat ruhet libri. Si një institucion kulturor i rëndësishëm sidomos për studentët dhe nxënësit, shpresoj që në bashkëpunim me kompetentët përfshirë këtu dhe Kuvendin e Komunës do të gjendet një zgjidhje sa më e shpejt e mundshme në funksion të krijimit të hapësirave për vendosjen e gjithë ekzemplarëve dhe funksionimit të plotë të Bibliotekës së qytetit.

Gjithashtu të gjithë këshilltarëve ju është shpërndarë edhe informata rreth gjendjes së Klubit të Futbollit Llapi që ka qenë kërkesë e disa prej asamblistëve të Kuvendit të Komunës. Edhe pse si Drejtori nuk kemi kompetencë dhe përgjegjësi të drejtpërdrejtë sa i përket mbikëqyrjes së funksionimit të KF Llapit, varësisht formës së organizmit të tij, megjithatë për hir të transparencës ju paraqitet kjo Informatë para juve këshilltarëve të Kuvendi.

Fillimisht mund t'ju informoj se pas ndërkombëtarizimit të Futbollit të Republikës së Kosovës, gjegjësisht pranimi në FIFA dhe UEFA, Federata e Futbollit të Kosovës - FFK ka marrë rekomandime që të fillohet me riorganizimin e klubeve sportive të Kosovës sa i përket statusit, gjendjes juridike të tyre dhe çështje tjera relevante të parapara me rregullat dhe standardet e këtyre dy institucioneve ndërkombëtare. FFK ka dërguar shkresë – Qarkore, të gjitha Klubeve të Futbollit duke rekomanduar që të gjitha Klubet të riorganizohen në bazë të legjislacionit në fuqi në mënyrë që të funksionojnë sipas standardeve ndërkombëtare dhe hapjen e mundësisë për licencim për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare, ngase pothuajse të gjitha klubet sportive të Kosovës të cilat kanë qenë Klube Publike para luftës të themeluara nga institucionet apo organizatat publike, pas luftës në bazë të Udhëzimit Administrativ 01/2005 për themelimin dhe regjistrimin e klubeve publike dhe private të sportit, neni 2.1, të gjitha Klubet Publike (futbollit, basketbollit, hendbollit etj) me automatizëm kanë marrë statusin OJQ, gjë që edhe KF Llapi ka funksionuar në bazë të këtij Udhëzimi. Në vitin 2016, drejtuesit e KF Llapit, kanë shprehë interesim për ndërrimin e statusit të Klubit me qëllim të hapje së rrugëve dhe mundësive të riorganizmit të Klubit sipas kushteve, kriterëve dhe standardeve ndërkombëtare. Si hap i parë, çështja është iniciuar për vendosje në Kuvendin e Komunës, përkatësisht ndërrimin e Statusit nga Klub me status OJQ, në Klub me status Shoqëri Aksionare ose Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, qëllim i së cilës ishte që Komuna të mbetet aksionare në Klub, së bashku me aksionarët tjerë që pretendohet të vinin sipas shprehjes së interesit në bazë të procedurave publike dhe transparente, për çka edhe është marrë vendim në Kuvendin e Komunës, i cili pas shqyrtimit të ligjshmërisë nga ana e MKRS-së, është vlerësuar se

”është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi” me arsyetim se në raste të tilla Komunitat nuk mund të interferojnë dhe të vendosin çështje të cilat kanë të bëjnë me OJQ si dhe nuk mund të jenë bashkë aksionarë, andaj edhe kanë rekomanduar që brenda afatit ligjor të bëhet shfuqizimi i vendimit në fjalë së bashku me aktet përcjellëse të tij që ishte vendimi për ngritjen e komisionit për zhvillimin e procedurave të shprehjes së interesit dhe propozimit të aksionarëve të KF Llapit. Njëkohësisht kanë referuar që ndërrimi i statusit të Klubit të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi - Ligji për sport. Kuvendi i Komunitas menjëherë në mbledhjen e radhës ka bërë shfuqizimin e vendimit në fjalë duke përfshirë edhe vendimin për ngritjen e komisionit për zhvillimin e procedurave të shprehjes së interesit dhe propozimit të aksionarëve të KF Llapit.

Nga kjo që u theksua, aq sa jemi të informuar edhe ne, organet e KF Llapit, kanë filluar marrjen e iniciativës për riorganizim të Klubit sipas sugjerimeve të MKRS dhe FFK-së, në funksion të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të parapara nga FIFA dhe UEFA, dhe përfundimisht në pjesën e dytë të vitit 2016 në mbledhjen e Kuvendit të Klubit, është vendosur për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ-së – Klubit Publik të Futbollit Llapit në Podujevë, me qëllim të themelimit të Klubit me organizim në formën e Shoqërisë Aksionare ose Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. Pas këtij vendimi, rreth organizimit dhe funksionimit të KF Llapit, Komunita – DKRS, nuk ka kompetenca dhe përgjegjësi ligjore të mbikëqyrjes, monitorimit dhe interferimit në KF Llapit, mirëpo mbetemi të përkushtuar për mbështetje të vazhdueshme sa i përket investimeve dhe krijimit të mundësive sa më të favorshme për zhvillimin e futbollit dhe sportit në përgjithësi në Komunitën e Podujevës.

z.Avni Fetahu, theksoi, e falënderojmë Drejtoreshën e DKRS-së për informatën e dhënë. Kemi një sugjerim tek çështja e klubeve sportive që janë në superligë, do të ishte mirë që në afatet kohore kryesisht kërkesat kur po i kanë si klube për mbulimin e shpenzimeve në Federatat përkatëse që ju kërkojnë, të kryhen me kohë në mënyrë që të mos t’iu krijohen obligime tek Federata. Pastaj do të ishte me interes që të gjendet mënyra më e shpejt e mundshme për funksionalizimin e Bibliotekës së Qytetit. Kemi edhe një çështje të cilën e kanë paraqitur klubet sportive që ka të bëjë me Palestrën sportive tek shkolla ‘Enver Maloku’, t’iu jepet prioritet numër 1 klubeve sportive që ushtrojnë, ndërsa aktivitete sportive të njerëzve të ndryshëm qoftë edhe të atyre që punojnë në Komunitën të lehen anash, konkretisht të mos ua nxënë kohen - terminet klubeve sportive. Pastaj është edhe një kërkesë e shoqatës SHBA ‘Llapit’ që merret me alpinizëm të cilët në vitin e kaluar janë subvencionuar me një shumë prej 300.00 €, dhe këtu ndoshta po foli në cilësinë e një dashamiri të natyrës që dal dhe eci dhe e di se çka mund të bënë ajo shoqatë më shumë për aktivitete të shumta të turizmit dhe formave tjera, kështu që do të ishte mirë që të trajtohet në mënyrë më meritore.

z.Bajram Ajeti, theksoi, ndoshta më së paku më takon mua të flas për kulturën sepse është rinia ajo që duhet të jetë bartëse e të gjitha iniciativave, mirëpo e mora fjalën për arsye se po mbështetem në një fjalë të popullit që thuhet ‘*nuk ka gjë më të vështirë sesa kur në ditë të vështira kujton të mirën*’, me këtë dua të them se kultura, sporti dhe rinia, ashtu siç është e pagëzuar kjo Drejtori, më bie keq prej kësaj vaje të re në moshë dhe më vie mirë që është femër, por është shumë keqe e që nuk e besoj se edhe i lejohet por edhe nuk e besoj se e ka mundësinë t’iu ofroj qytetarëve të Llapit atë që kanë nevojë për kulturë. Kam menduar të shkoj shumë gjatë dhe gjerë por megjithatë nuk do të lëshohem shumë. U fol rreth Klubit të Futbollit Llapit, më kujtohet dhe mund ta mbani mend edhe ndonjëri prej juve këtu që KF Llapit ka qenë në një formë një ndër motivuesit kryesor të mbajtjes gjallë të atdhetarizmit në kohën e pushtimit, deri në 10000 shikues nëpër livadhe – fushë në fshatin Dumnice e tutje, tutje, kurse sot të tejkalohet kjo pa u ditë e vërteta, ç’ndodhi me KF Llapit. Kur në vitin 2005 u bë OJQ, pastaj siç jeni në dijeni në vitin 2013 nga kjo asamble është marrë një vendim me përpjekje për ta bërë shoqëri aksionare etj etj, mirëpo një gjë është mirë ta dini edhe ju edhe

qytetarët se çështja e KF Llapi është në procedurë penale, dhe atë jo vetëm për çështje që ky Klub nuk është trajtuar kurrë drejtë, por për arsye se ka pasë edhe falsifikime të procesverbaleve, posaçërisht kur ka qenë në pyetje procesverbali i Kuvendit si OJQ. Kështu që ka ardhur tani dhe të iket prej kompetencës së një Klub apo një institucion (po e quaj kështu) i kulturës dhe sportit të Komunës, dhe t'i lëhet përgjegjësia vetëm FFK-së, unë mendoj se është e padrejtë. Çështje tjetër ka të bëjë me Bibliotekën e Qytetit, e që unë mendoj se është dashur të jetë një shqetësim edhe më i madh, dhe nuk e them rastësisht këtë sepse kur e kujtoj Bibliotekën e Komunës tonë në vitet kur ka qenë vështirë dhe rëndë dhe kur e shohim sot të burgosur, të keqtrajtuar, terrorizuar librat e Bibliotekës tonë unë mendoj se kjo gjendje paraqet shqetësime dhe duhet të jetë alarm për shoqërinë tonë, sepse administratës së Komunës nuk po ia ndien dhe kjo po duket, megjithatë librat qëndrojnë të burgosura kurse kërkohet dhe thuhet që ndoshta do të gjemë një zgjidhje, unë kërkoj të gjendet një zgjidhje sa më shpejt të jetë e mundur, sepse me të vërtetë kjo është e pafalshme, të terrorizohet libri dhe të mos i ofrohet mbi 600 lexuesve që janë nxënës, student etj, e që edhe në ato kushte ka qenë mjaft shumë e vizituar, unë mendoj se kjo situatë është për tu kritikuar dhe është autokritikë vetvetes, ose nuk dini se ç'është autokritika ose nuk doni të dini që nuk jeni në nivel ngase qëndrimi i tillë ndaj librit dhe pa një shtet të dijes mendoj se nuk kemi ku të shkojmë.

Pastaj është detyrë përkrahja e kulturës, dhe në këtë aspekt janë 5 ligje të cilat rregullojnë çështjen e Ministrisë dhe Drejtorive për kulturë, rini dhe sport. Të marrim shembull nga raporti – informata, Shoqëria ‘‘Josip Rela’’, është shoqëri e cila vetëm qëndron gjallë dhe i ka gramat e fundit, pse, vetëm nga moskujdesi i kësaj administrate komunale. E dini mirë kush ka qenë dhe sa e sa gjenerata janë shfrytëzuar nga arti dhe kultura që ka krijuar ajo shoqëri, apo të marrim thjesht Shoqërinë ‘‘Mirela’’ e cila është një shkollë e cila i plotëson kushtet por megjithatë ka mbledhur të rinjë dhe e cila po bënë jehonë jo vetëm në nivel komunal por besa edhe ndërkombëtar deri në Suedi, çka bëhet dhe çka është bërë për këtë shoqëri. Po ndalemi edhe tek Teatri ‘‘Avdush Hasani’’, jeni në dijeni shumë mirë se ka një Ligj për Teatrot dhe një Ligj mbi Institucionet kulturore, jeni në dijeni se për të qenë teatro komunal duhet të ketë edhe drejtor të përgjithshëm, drejtor artistik, edhe një trup artistësh qoftë rezident qoftë profesionist të cilët duhet të sigurohen me marrëdhënie pune dhe të shihet se çka ka teatri. Në raport të DKRS-së flitet për ‘‘Teatrin Ndryshe’’ mirëpo në këtë ngjarje a pati ndonjë pjesë teatrale që u luajt nga Llapjanët, por vetëm u huazuan nga jashtë madje edhe nga Shqipëria duke mos jua siguruar kushtet si aktorë. Mendoj se rreth 15 punëtorë të DKRS-së marrin paga kurse shumë më pak se ato paga investohet për kulturë. Çështje tjetër, është mirë të jepen të dhëna se sa po ka përkrahje nga buxheti i Komunës, kështu që niveli i kulturës në një raport i cili ka faqe por nuk ka përmbajtje dhe që krijohen ‘‘zorrë qorre’’ grupe të ndryshme rinore me orientime e herë herë me përkatësi politike, unë mendoj se nuk është zgjidhja për kulturës. Llapi e meriton të trajtohet drejtë të ketë planifikime, pse jo të krijohet edhe strategji për këto tri fusha, pastaj kemi ligj të veçantë për fuqizim të rinisë, ndërsa shtrohet pyetja, çfarë është bërë. Kështu që unë mendoj se ky është një raport i cili nuk ka përmbajtje, nuk tregon gjendjen e vërtetë të kulturës në Llap, andaj sërish po kthehem dhe po i referohem asaj fjalisë së urtë popullore, përderisa në kohën e pushtimit Llapi ka pasë 17 shoqëri kulturore-artistike, sot ka një ‘‘Josip Rela’’ dhe ‘‘Mirela’’ e cila është e re në këtë aspekt, kurse ‘‘Josip Rela’’ e traditës, mirëpo me këtë qëndrim që ka administrata komunale unë mendoj se kulturën e kemi shumë keq dhe është alarmante jo vetëm për administratën komunale, jo vetëm për DKRS-në por edhe në përgjithësi për të gjithë qytetarët e Llapit.

z.Arbër Blaku, theksoi, unë dëshiroj të ndërlihem vetëm sa i përket Klubit Futbollistik Llapi, pa keqkuptime por Drejtoresha e DKRS-së është munduar paska të na pësjtjellë me disa çështje tjera por ne vetëm për KF Llapin kemi kërkuar raport.

Nuk di se për cilin Llap jemi duke diskutuar sot ne këtu, sipas informatave që kam unë dhe që kam hulumtuar që disa muaj, Llapit e ka një emër të cili e njohim të gjithë dhe me të cilin jemi rritë ne, ai është Klubi Futbollistik Llapit, përndryshe është zyrtarisht FC Llapit - KF Llapit. Këtu kemi një Klub tjetër apo biznes tjetër i cili është duke i shfrytëzuar pasuritë e Llapit, mirëpo është një dhe njihet si Llapit 1932, kurse mund të jenë edhe shumë tjera siç është shembull Trepça 89 etj etj, mirëpo është vetëm një Klub dhe ai quhet FC / KF Llapit.

Në këtë aspekt cilat janë procedurat që e gjithë pasuria, stadiumi dhe e gjithë historia e KF Llapit ju është dhënë në pronësi atij biznesi, në cilin vendim apo në cilën procedurë jeni bazuar, kur e them këtë fjalën e kam tek gjithë historia e Klubit, ngase po të flasim për pronën, e gjithë kjo është duke ndodhur për këtë parkingun përball Komunes në mënyrë që ata që e mbajnë këtë Klubin e tanishëm të vijnë pastaj të ndërtojnë banesa 7-8 apo edhe 14 kate, ne e dimë këtë, mirëpo me ato falsifikime që keni bërë, përkatësisht është falsifikuar nënshkrimi i Emin Ajvazit dhe për këtë, edhe pse është në procedurë gjyqësore, publikisht thërras prokurorinë e shtetit dhe unë do t'ju jap fakte sa të duan, se është falsifikuar nënshkrimin, e kanë shitë Llapin për "2 pare", Klubin me të cilin jemi rritë të gjithë ne këtu, ja kanë dhënë një biznesmeni i cili e ka punën e vetë, por që nuk është ai për këtë punë. Nuk mund të vijë dhe të na thotë ai person neve që pak me dashtë unë e mbylli Llapin nesër, nuk ka kompetencë ai person sepse nuk ka pas as shkie, as bugar, as magjup që kanë mund të vijnë dhe ta mbyllin Llapin, kurse ai person thotë që po të dua unë nesër e mbylli Llapin, kush i ka dhënë atë të drejtë atij personi që të dal me deklarata të tilla mediale e nderuar Drejtoresh e DKRS-ës, prandaj tregona formën se si ja keni falë Llapit historinë. Unë pajtohem që Klubi duhet të jetë me Partneritet Publiko Privat etj etj, në rregull krejt, por të respektohet rregulli, e jo të thuhet mere është e jotja, për çka, për një parking, e që u bëmë horë në krejt Kosovën për këtë farë pune.

z.Blerim Maqastena, theksoi, në këtë pikë desha të ndalem në dy tema ku njëra ka të bëjë me KF Llapin e që do të zgjat pak më shumë. Drejtoresh, një pasqyrë e mangët, e cektë e pa detajuar, disa mbështetje për Klube, për kulturë dhe nuk ka shifra financiare, unë pash disa shifra këtu dhe njëra ishte 7500.00€ dhe mendova që kanë investuar me këtë shumë në ndonjë turnir ose diçka të ngjashme, por kur e vërejtja ai numër ishte për spektator, dhe kjo gjë më bërë të dal dhe t'ju them që nëse nuk i sjellni herëve tjera më të detajuara këto gjëra, votën time si përfaqësues i partisë Socialdemokrate nuk do ta keni.

Sa i përket Klubit Futbollistik Llapit, unë i kam disa pyetje, vlen të ceket se sa i përket anës sportive vërtetë jam i kënaqur me suksesin Klubit Llapit, ngase nga paslufta ky Klub ka qenë një farë forme vetëm në letër, kështu që nuk ka pasë mundësi të bëjë gara në nivel çfarë bënë tani, kurse sa i përket stadiumit të qytetit, pyes Nënkryetarin e Komunes meqë ai është prezent këtu në vend të Kryetarit, si dhe për Drejtorin e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, a ka leje ndërtimi stadiumi i Llapit, nëse po, a ka plan dhe çfarë parasheh në atë stadium, pastaj e keni menduar një gjë që ju keni dhënë një pëlqim në vitin 2016, pëlqim i cili parasheh një riorganizim të fushës, do të thotë me bari sintetik, dhe tani nëse ju nuk keni dhënë leje për ndërtim të tribunave, atëherë qysh mendoni se do të licencohet ky stadium pran UEFA-s. Nëse keni përgjigje, sërish do të doja të debatoj.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, Drejtoresha e DKRS-së në fjalën hyrëse foli shumë qetë rreth Bibliotekës dhe tha se po lexohen librat etj, mirëpo unë desha t'i them asaj që nuk e tha aspak të vërtetën, me një fjalë mund t'i them se po gënjen sepse nuk është duke e shfrytëzuar askush librin dhe për këtë çështje nëse doni edhe pas kësaj seance mund të shkojmë bashkërisht dhe të shikojmë se a po mund të marrim ndonjë libër. Pastaj, përveç që nuk ke bërë asgjë për Bibliotekën e cila në fakt është mbyllë, e që është dashur të shfrytëzohej ndonjë objekt me qira, edhe për arkivin komunal që është institucion me një gjendje të mjerueshme i anashkaluar tërësisht nuk keni bërë asgjë sepse aty janë të rrezikuara edhe lëndët por edhe personeli i cili i ekspozohet oksidimit dioksid të karbonit.

z.Vendenis Lahu, theksoi, dua të shtroj një pyetje, siç jemi në dijeni në formacionin e kaluar të Kuvendit të Komunës është themeluar një Komision nga përbërja e Kuvendit i cili ka pas për detyrë të shqyrtoj statusin e KF Llapit. Sa jam në dijeni ai komision është mbledh vetëm njëherë, andaj pyes, çka ka ndodh mandej me atë komision, çfarë vendimesh ka marrë ai komision, thjesht çka ka ndodh me atë komision, a është shkarkuar apo çka.

z.Fatmir Rudari, theksoi, sa i përket komisionit për të cilin foli parafolësi, unë kam qenë pjesë e atij komisioni, mirëpo për të njëjtin thuhet edhe në informatën e DKRS-s që ai komision është shfuqizuar pas shqyrtimit të ligjshmërisë. Mirëpo sa i përket temës, unë kam pyetje, KF Llapi pronë e kujt është tani, a ka Komuna asete në KF Llap, apo është vetëm pronë e Vëllezërve Batatina, prandaj nëse mundet ndokush të jap përgjigje se a ka Komuna ndonjë përqindje apo diçka tjetër në KF Llapin.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, sa i përket pyetjes rreth lejes për stadium, unë personalisht nuk e di a ka apo jo leje ndërtimi sepse që rreth një vit jam emëruar drejtor në Drejtorinë përkatëse. Çështje tjetër, investimet në atë stadium i bënë Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit e jo Komuna, mirëpo për leje ndërtimi unë do të shikoj gjendjen reale si qëndron, do të shoh projektin dhe të shohim pastaj.

z.Blerim Maqastena, theksoi, Drejtori parafolës e thotë se nuk e di a ka leje për një stadium të qytetit, kjo ndoshta është e arsyeshme sepse ky Drejtor nuk ka qenë në mandatin e kaluar, por është dashtë të përgjigjej ish Drejtori, por që nuk është këtu prezent. I nderuar Drejtor i DPUMM sigurisht jeni në dijeni se rikonstruktimi i stadiumi i Prishtinës ka zgjatë 2-3 vite, në atë rikonstruktim inspektorët e UEFA-s janë ardh disa herë dhe nuk e kanë pranuar atë stadium deri sa është punuar ashtu siç është dashtë, andaj me çfarë të drejte lejoni investime në një stadium për të cilin unë ju garantoj se nuk kalon te inspektorët e UEFA-s ai stadium, nuk ka hapësirë ai stadium, as nuk ka hapësirë për tribunë, mandej ku e keni marrë këtë shembull që tribunat kryesore të jenë prapa portave, apo kjo ndodh vetëm tek ne, por që e njëjta është edhe në sallën e sporteve “Hakif Zejnullahu” dhe kemi qenë temë e mediave, kështu që nëse një ekip kundërshtarë vie dhe nuk ka se ku të parkoj autobusin, sepse nuk ka hapësirë ai stadium, mirëpo nëse lejohet të ndërtohet ai stadium do të investohen qindra mijëra euro dhe sërish nuk do të kenë mundësi qytetarët të shohin gara ndërkombëtare në Llap, këtë e keni të sigurt, me çfarë të drejte jua ndaloni qytetarëve, me vetëdije apo mos vetëdije, të përcjellin Llapin në gara ndërkombëtare në Llap. Përse KF Llapi ndoshta në të ardhmen të luaj në Prishtinë kur kemi mundësi t’i bëjmë në Llap. Përse nuk ndani një lokacion ashtu siç e keni ndarë për stadiumin e dytë, dhe t’i ndërpritni punimet. Pra nuk bënë të thuhet ose të mendohet se investimet i bënë Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit kurse ne po rrimë, sepse duhet të ndërpriten ato punime dhe ato investime, në të kundërtën do t’i lëni qytetarët dhe sportistët Llapjan pa sport.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, e falënderoj parafolësin për shqetësimin e ngritur, shqetësim i cili besoj se është i ligjshëm, megjithatë unë po e shfrytëzoj rastin ta përgëzoj Drejtoreshën e Kulturës Rinisë dhe Sportit qoftë për përgatitjen e informatës qoftë për punën që bënë dhe në këtë drejtim Drejtoresha e ka mbështetjen e plotë të Ekzekutivit të Komunës. Sa i përket pyetjeve dhe çështjeve të shtruara do të mundohem shkarazi të përmend disa që janë me interes për të gjithë ne dhe në veçanti për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës. Meqë po diskutojmë për kulturë, për rini, për sport, dhe në këtë aspekt u përmend Shoqëria Kulturore Artistike “Josip Reli” e cila vërtetë është një shoqëri e cila na ka bërë krenarë, unë kam pas fatin që të jem kryetar i kësaj shoqërie për rreth 6 vite deri sa më është pamundësuar për shkak të pozitës së Nënkryetarit të Komunës. Dëshiroj t’ju njoftoj se jemi në procedurë të hartimit të statutit dhe Rregullores që do të sjellët në këtë Kuvend që këtë shoqëri kulturore artistike ta shndërrojmë në ansambël të këngëve dhe

valleve popullore në mënyrë këtë shoqëri ta ndihmojmë jo vetëm sa për të mbijetuar por edhe të zgjerohet me raportuar dhe ata njerëz që vërtetë janë marrë kohë të gjatë me kultivimin dhe ruajtjen e këngës dhe valles popullore të na përfaqësojnë denjësisht sikurse deri më tani, mirëpo për shkak që Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit ka nxjerrë prej atëherë një varg ligjesh dhe akteve nënligjore po thuajse është bërë e pamundur që shoqëritë kulturore artistike të performojnë sepse krejt kjo bëhet me ftesë ose thirrje publike që vërtetë është një absurd i kohës konsideroj ngase po ta zëmë kemi Ditën e Dëshmorëve ose Ditën e Çlirimit të Komunës së Podujevës apo edhe 17 shkurtin, dhe sipas legjislacionit në fuqi duhet të bëhet thirrje publike për shoqëritë kulturore artistike që të vijnë të performojnë një program në qytetin e Podujevës dhe me këtë një shoqëri kulturore artistike nga Gjakova do të mund të konkurronte me çmim më të lirë dhe të merr programin artistik për nderë të shënimit të festës përkatëse, kjo vërtetë është absurde por kështu është, andaj për t'i ikur kësaj ne kemi filluar procedurat që këtë shoqëri ta shndërrojmë në ansambël të këngëve dhe valleve të qytetit të Podujevës e që besoj se do të ketë edhe miratim e plotë nga ana juaj në mënyrë që Ju si Kuvend së bashku me ne Ekzekutivin e Komunës t'i ndajmë buxhet aq sa kemi mundësi për funksionimin e atij ansambli, mirëpo tani nuk mund ta bëjmë atë.

Sa i përket sportit, në veçanti Klubit Futbollistik Llapi, besoj që të gjithë ne ndihemi krenar për sukseset dhe rezultatet e arritura të këtij Klubi sepse nuk është kohë e largët që KF Llapi ka qenë në ligën e dytë kurse tani është një prej pretendentve për titull kampion, ndërsa sa i përket aseteve dhe vërejtjeve që i bëri z.Blerim Maqastena unë plotësisht jam dakord që stadiumi aktual i Klubit Futbollistik Llapi nuk i plotëson kushtet për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare dhe nuk kemi çfarë të fshehim për këtë, ai stadium është në atë vend ku ka qenë dhe ndoshta është mirë në një të ardhme bashkërisht me Ju të vendosim për caktimin e një lokacioni të ri për stadium, jashtë qytetit sepse zakonisht stadiumet ndërtohen jashtë qytetit në mënyrë që mos të ketë pengesa të mëdha me rastin e zhvillimit të ndeshjeve, dhe bashkë me MKRS-në dhe me përkrahje të FFK-së si dhe ndoshta edhe me përkrahje të institucioneve tjera ndërkombëtare edhe Komuna e Podujevës ta ketë një stadium i cili do t'i plotësonte kushtet për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare, por deri atëherë ne nuk kemi mund të presim dhe t'i themi KF Llapit (rri atje në ara të Dumnicës deri sa ta kemi një stadium), sepse një gjë e tillë kërkon kohë, financa etj. Andaj KF Llapi duhet t'i zhvilloj garat në këtë nivel të kampionatit të Kosovës në atë stadium që është, me shpresë që ai nuk do të jetë stadiumi i së ardhmes së futbollit Llapjan. Ndërsa çështjet tjera që u ceken, Drejtori i DPUMM e dha një arsyetim, por unë e di që ka pas një pëlqim paraprak urbanistik të lëshuar nga Komuna kur MKRS ka filluar investimet në stadium por më tutje nuk jam në dijeni se çfarë ka ndodh sa i përket lejes së ndërtimit, por të gjithë jemi dëshmitar për stadiumin se çfarë ka qenë dhe si është përmirësuar në fushë dhe tani është në përfundim të ndërtimit të tribunave, megjithatë në fund ai stadium me siguri se do të shërbej për aktivitete të ndryshme sportive, por ne synojmë që KF Llapi vërtetë në një të ardhme afatmesme ta ketë një stadium konform kushteve dhe kriterëve që kërkohen.

znj.Donika Sfishta, Drejtoresh e DKRS-së, theksoi, unë vetëm dëshiroj t'i përgjigjem këshilltares së LVV-së znj.Doruntina Hasani, për akuzën, në fakt fyerjen që më bëri duke më thënë se po gënjen, andaj unë them se vet qasja e tillë tregon nivelin tuaj dhe mund të paramendoni një individ i tillë, me këso qasjeje dhe me një fjalorë të tillë të parashtrij pyetje që ndërlidhen me kulturën. Kjo sjellje e juaj tregon se sa keni njohuri për kulturën apo leximin dhe është fatkeqësi që të mendosh ti për vlerën e Bibliotekës. Edhe njëherë e përsërisë që të gjithë nxënësit dhe studentët që kanë qenë të interesuar janë furnizuar me literaturë të Bibliotekës.

Sa i përket çështjeve rreth Klubit të Futbollit Llapi, nuk është kompetencë e imja t'iu përgjigjem ngase unë jam drejtoresh e DKRS-së vetëm që një vit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, të nderuar, luteni që të respektoni kodin e mirësjelljes dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe mos të bëhen fyerje, ofendime e të ngjashme, andaj kërkoj t'ju përmbaheni rregullave ngase edhe në diskutime ka rregulla.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, të nderuar, nëse unë po gënjejë diçka apo nëse unë nuk jam për kulturë, atëherë pas seancës mund të shkojmë dhe të shikojmë a janë apo jo të vërteta ato që i ceka, përkatësisht shkojmë dhe shikojmë a mund të marrim ndonjë libër për lexim apo jo, dhe kur e them këtë jam e sigurt sepse kam informacione të sakta.

z.Fitim Haziri, theksoi, në bazë të asaj që u paraqit nga parafolësit rreth KF Llapit, unë desha të ndërlihem me ndërtimin e tribunave për të cilat Nënkryetari i Komunës e tha se paraprakisht është dhënë një pëlqim për ndërtimin e atyre tribunave. Është një shqetësim i banorëve përreth stadiumit të KF Llapit që ndërtimi i tribunave ka arrit pothuajse në katin e tretë dhe shumë afër. Kur institucionet luftojnë që qytetarët të mos bëjnë ndërtime pa leje, kurse në këtë rast kemi institucione që vetë institucioni ka bërë ndërtim pa leje, andaj për këtë do të donim që Drejtori i DPUMM në seancën e radhës të na njoftoj se a ka leje ndërtimi për ato tribuna apo jo sepse me të vërtetë janë cenuar banorët afër stadiumit. Sa i përket asaj që Drejtoresha e DKRS-s e përmendi çështjen e kulturës, është e pakulturë nëse i thua po rrenë ndokujt, por nëse i thua po gënjen disi është paksa me kulturë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, rreth kësaj informate edhe në KPF i kam thënë Drejtoreshës së DKRS që e ke të vështirë sepse është viti i parë që drejtoni atë Drejtori dhe problemet janë më të thella, por nëse përgjigje direkte nuk mund të jap Kryetari ose Nënkryetari i Komunës, atëherë shumë pak kërkoj të jap përgjigje ndonjë prej Drejtorëve apo Drejtoresha në këtë rast për ndonjë problem të caktuar, andaj edhe nuk po dëshiroj përgjigje direkte prej Drejtoreshës së DKRS ngase është Nënkryetari i Komunës këtu prezent ai i cili duhet të mbuloj përkatësisht aty ku nuk mund të jap përgjigje ndonjë Drejtor. Unë e di që sot askush nuk mund të jap përgjigje për këtë çështje përkatësisht për KF Llapin, duhet ta dimë se si është statuti i KF Llapit, si është i rregulluar dhe çka është puna e këtij Klubi, duhet të dimë rreth pronës ku funksionon Klubi, duhet ta dimë a ka aksione Komuna në Klub dhe nëse po sa janë ato me përqindje, si dhe duhet t'i dimë edhe sanksionet që duhet të ndërmerren nëse ndokush ka keqpërdor ndonjë dokumentacion për një çështje të caktuar.

Ne shumë mirë jemi në dijeni se Drejtoresha e DKRS-së kurrfarë faji nuk ka lidhur me këtë çështje sepse ju është kërkuar ku raport në momentin e papërshtatshëm por meqë je Drejtoresh unë të them të mos shqetësoheni sepse ju duhet të thoni që prej se jam unë Drejtoresh këto letra i kam, por e kam parasysh që si vajzë që je e keni paksa më të vështirë ngase për nga natyra femrat funksionojnë ndryshe, por në rregull është. Unë tani po foli personalisht, nëse Komuna nuk ka aksione në KF Llapin, duhet të thuhet një gjë e tillë nga Nënkryetari qysh pas diskutimit tim, edhe pastaj mbyllet debati, pastaj Nënkryetari është në rrjedha të transformimit të Klubit nga OJQ në shoqëri aksionare sepse keni qenë pjesë edhe në mandatin e kaluar. Nëse kryesia e kaluar e Klubit e ka falsifikuar dokumentin që u cek e që është dokument zyrtar, e që është në proces penal, do të thotë fjalën e vet ai tjetri organ. Pastaj nëse ne si Komunë e dimë që UEFA i ka dhënë të drejtë Kosovës për organizimin e para-kualifikimeve, është mirë që edhe ne të marrim ndokund një hapësirë nëse ekzistojnë mundësitë dhe nëse ka tokë, në të kundërtën nuk kemi çfarë të bëjmë, që në të ardhmen Klubi të Futbollit Llapin t'i krijojmë kushte me ndërtimin e një stadiumi modern qoftë edhe deri në vitin 2025, por investimet të mos shkojnë huç. Nëse vërtetë bëhet ndërtimi i tribunave deri në katin e tretë dhe nuk ka leje ndërtimi apo ndonjë planifikim në ato parametra që është duke u ndërtuar ajo pjesë e stadiumit, është mirë që në të ardhmen dikush ta shikoj këtë çështje në këtë rast z.Durim Salihu është Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit duhet të dal në vend dhe të shikoj më gjerësisht rreth lejes së ndërtimit dhe parametrave të planifikimeve të vazhdohet tutje, mirëpo nëse ne lejojmë të bëhen të gjitha ato investime nga MKRS të shkojnë në dëm, është mirë të ndalohej kjo dhe të futen në ndonjë

pronë tjetër që parashihet nga Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë. KF Llapit e ka mbështetjen gjithherë nga ne dhe besoj se askush këtu nuk është kundër Klubit, as kundër ndonjë subvencionit dhe kur do që DKRS parasheh dhe ka mjete buxhetore për përkrahje të KF Llapit, jam për ta mbështetur dhe do ta keni. Kështu që në këto pika që i ceka është mirë të ndalemi sa i përket KF Llapit. Sa i përket subvencionimeve të Klubeve, është mirë ta dimë me shuma të caktuara se kush dhe sa është mbështetë dhe në bazën e mbështetjes.

Sa i përket debatit për Bibliotekën e Qytetit, e dëgjova edhe komunikimin e mëparshëm, por unë mendoj më së paku ka faj Drejtoresha e DKRS-së sepse kjo nuk e ka rrënuar objektin ku ka qenë Biblioteka. Pa u rrënuar ai objekt Kryetari i Komunës është dashtë të mendoj se ku të dërgoj librat sepse ka qenë në dijeni se janë 40000 mijë libra – tekste, si dhe janë disa Organizata të ndryshme të cilat kanë pasë zyrat e tyre në atë objekt, prandaj pa u rrënuar objekti është dashtë t'i bëhet zgjidhje qoftë librave qoftë atyre shoqatave, andaj fare mos e ndieni vetën në siklet ju si Drejtoresh e DKRS-së sepse nuk je fajtorë ti, por problemi qëndron në krye të institucionit. Pyetja ime kryesore është, a ka ndonjë plan afatshkurtër që Biblioteka e Qytetit të funksionalizohet, nëse jepet përgjigje se do të ndërtohet objekti i ri, atë e di, por ju them se do të shkoj edhe ky mandat dhe nuk do bëhet asgjë, ashtu siç do të na shkoj edhe neve ky mandat në këtë sallë dhe me këto kushte. Kështu që kjo informatë e DKRS-së nuk i nënshtrohet procedurave të votimit sepse është informatë që tregon gjendjen aktuale dhe nuk mund të ndryshohet asgjë, këtë e keni pasë këtë e keni sjellë, por është mirë që ne si Kuvend sot të dalim me një rekomandim, të shikojmë statusin e KF Llapit, të shikojmë pronën e Klubit, të shikojmë çfarë mbështetje po i japim KF Llapit, të shikojmë kush dhe çka po bëhet me këtë Klub, sepse askush nuk mund ta privatizoj KF Llapin, qoftë me dokumentacione qoftë me falsifikime apo forma tjera, e them këtë sepse kam qenë në MKRS dhe jam interesuar ku pa e dhënë nënshkrimin personi kompetent e që është Emin Ajvazi është e kotë, mirëpo dikush duhet t'i vë në rregull për t'i rregulluar këto çështje, përndryshe po të kemi një person që është i vendosur, këto gjëra rregullohen shumë shpejt, por duhet vendosmëri e jo të punohet me telefonata.

z.Arbër Blaku, theksoi, Nënkryetari i Komunës e tha se jemi krenar me sukseset e KF Llapit, ju lutem për cilin Llap e keni fjalën, për Llapin që kemi qenë bashkë në Dumnicë dhe që e njohim dhe që ka histori, apo për këtë Llapin tjetër që është duke u bërë, pra nuk është ky ai KF Llapit i yti dhe i imi që jemi rritë bashkë me të i nderuar Nënkryetar. Andaj meqë keni qenë nga fillimi në procedura të privatizimit të KF Llapit po dëshiroj sqarim se ky Llap i tanishëm nuk është ai Llapit yt dhe i imi, sepse unë po e shoh në dokumente.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, konsideroj se debatet rreth kësaj pike përfunduan. Falënderoj Drejtoreshën e DKRS-së për angazhimin, informatën e sjellë dhe punët që keni kryer dhe sigurisht që do të vazhdoni të kryeni gjithherë e më mirë. Sugjeroj që shqetësimet, rekomandimet propozimet dhe vërejtjet që janë me vend është mirë që gjithherë të merren parasysh nga secili.

Kalojmë në pikë e radhës, pikë shtesë e cila hyri me propozim të Grupit të LVV-së.

7. Propozim vendimi që kompanisë private për distribuim dhe furnizim me energji elektrike, "KEDS" i ndalohet vendosja e njësorëve për matjen e energjisë elektrike në shtyllat e rrjetit elektrik në hapësirat publike në tërë territorin e Komunës së Podujevës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi të bëjmë me një pikë shtesë e cila në fillim të kësaj mbledhjeje hyri me propozimin e Grupit të këshilltarëve të LVV-së. Andaj nëse ka diçka për të shtuar urdhëroni fjala është për propozuesin e kësaj pike.

z.Fitim Haziri, në cilësinë e propozuesit të kësaj pike e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së kemi paraqitur para jush një propozim vendim që Kompanisë private për distribuim dhe furnizim me energji elektrike, KEDS i ndalohet vendosja e njësorëve për matjen e energjisë elektrike në shtyllat e rrjetit elektrik në hapësirat publike në tërë territorin e Komunës së Podujevës. Arsyeja e këtij propozim vendimi është se Kompania KEDS kohëve të fundit ka vendosur njëhsor elektrik në disa vendbanime të Komunës së Podujevës, siç janë fshatrat Llapashticë, Katunishtë, Gllmanik, Konushefc, Dobratin, Lladoc, Shajkoc, Peran, Obrançë dhe Latanc, ku qytetarëve të këtyre fshatrave po iu shkelet e drejta elementare e njeriut që është barazia dhe transparenca. Kompania KEDS duhet ti furnizoj qytetarët me energji elektrike duke respektuar parimet e barazisë dhe transparencës. Në Komunën e Podujevës këto dy parime janë duke u shkelur, kemi lokacione ku Kompania KEDS ka vendosur njëhsorë poshtë shtyllave elektrike ndërsa kemi lokacione tjera ku njëhsorët e energjisë elektrike janë vendosë në maje të shtyllave elektrike, këtu është shkelur parimi i barazisë, ndërsa vendosja e njëhsorëve në maje të shtyllave elektrike është jo transparent dhe i jashtëligjshëm, andaj të nderuar këshilltarë të Kuvendit të Komunës së Podujevës, ne jemi të zgjedhurit e qytetarëve të Komunës për t'i mbrojtur të drejtat dhe interesat e qytetarëve, ftoj që të miratoni *propozim vendimit që Kompanisë private për distribuim dhe furnizim me energji elektrike, KEDS i ndalohet vendosja e njësorëve për matjen e energjisë elektrike në shtyllat e rrjetit elektrik në hapësirat publike në tërë territorin e Komunës së Podujevës*

Arsyeja e ndalimit të vendosjes së njësorëve për matjen e energjisë elektrike në hapësira publike bëhet për arsye të shkeljes së të drejtave elementare të njeriut që është siguria dhe transparenca në qasje të gjendjes së shpenzimeve elektrike në njësorët elektrik.

Kompania KEDS obligohet që t'i zhvendosë të gjithë njëhsorët elektrikë që i ka vendosur në maje të shtyllave elektrike në të gjithë territorin e Komunës së Podujevës që qytetarët të kenë qasje për ta parë gjendjet e shpenzimeve elektrike në një afat kohore prej 90 ditëve.

Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe shqyrtimi administrativ nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Drejtoria e Inspeksionit. Andaj shpresoj në votën e juaj.

Në formë fizike paraqitet propozim vendimi si në vijim:

Bazuar në nenin 39 paragrafi 39.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 65 paragrafi 65.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës si dhe nenin 33 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Këshilltarët e Lëvizjes Vetëvendosje! në Komunën e Podujevës, Kuvendit të Komunës së Podujevës i propozon;

VENDIM

QË KOMPANISË PRIVATE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE, ‘KEDS’ I NDALOHET VENDOSJA E NJËSORËVE PËR MATJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NË SHTYLLAT E RRJETIT ELEKTRIK NË HAPËSIRAT PUBLIKE NË TËRË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS.

Neni 1

Kuvendit të Komunës i propozohet për miratim të vendimit që kompanisë private KEDS i ndalohet vendosja e njësorëve për matjen e energjisë elektrike në shtyllat e rrjetit elektrik në hapësirat publike në tërë territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 2

Arsyeja e ndalimit të vendosjes së njësorëve për matjen e energjisë elektrike në hapësira publike bëhet për arsye të shkeljes së të drejtave elementare të njeriut që është siguria dhe transparenca në qasje të gjendjes së shpenzimeve elektrike në njësorët elektrik.

Neni 3

Kompania KEDS obligohet që t'i zhvendosë të gjithë njëhsorët elektrikë që i ka vendosur në maje të shtyllave elektrike në të gjithë territorin e Komunës së Podujevës që qytetarët të kenë qasje për ta parë gjendjet e shpenzimeve elektrike në një afat kohore prej 90 ditëve.

Neni 4

Vendimi hynë në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe shqyrtimi administrativ nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Drejtoria e Inspeksionit

z.Avni Fetahu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së me dëshirën më të madhe do ta përkrahim këtë propozim vendim si të tillë, por konsiderojmë se një propozim vendimi të tillë paraprakisht duhet t'i paraprijë një bazë ligjore, dhe nuk di sa është e rregulluar kjo çështje ligjërishit që ne si këshilltarë të Kuvendit të Komunës të marrim vendim që një operatori të caktuar t'i ndalohej një veprim i caktuar.

Ashtu siç e cekta edhe në fillim, ne nuk patëm fatin që këtë temë ta trajtojmë dhe ta diskutojmë paksa më gjatë, mirëpo me Drejtorin e DPUMM diskutuam dhe ai tha që ka gatishmëri që të sjellë ndokënd nga Zyra e Rregullatorit për Energji - ZRRE apo ndokënd që është përgjegjës dhe t'i diskutojmë hapur këto shqetësime të cilat edhe për ne janë shqetësime përse diku vendosen njëhsorët sipër në shtylla elektrike e diku poshtë, gjë e cila nuk është e drejtë. Atë që e lexova në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, po e lexoj vetëm pikën 1, thuhet, *ky ligj përcakton kompetencat, detyrat dhe funksionet e Zyrës së Rregullatorit për Energji përfshirë kushtet për dhënien e licencave për kryerjen e aktiviteteve në fushën e energjisë*, dhe tani shembull, është ZRRE dhe shumë organe tjera përgjegjëse që e përcaktojnë ku mund të vendoset një njëhsorë i energjisë, kurse ne tani si Kuvend i Komunës të marrim vendim për një gjë të tillë, pa e diskutuar paraprakisht më në detaje, unë personalisht por edhe si Grup i këshilltarëve të LDK-së e konsiderojmë të kundërligjshëm.

z.Hamdi Jaha, Drejtor i DPUMM, theksoi, unë edhe njëherë do të sqaroja këtë çështje sepse vendime mund të merren sa herë që dëshirojmë por që mund të jenë në kundërshtim me ligjet në fuqi dhe në kundërshtim edhe me qytetarët. Me disa këshilltarë të Kuvendit biseduam pak më parë dhe ju thash që nëse paraqitet nevoja dhe e shihni të arsyeshme këtu mund të formojmë një grup prej këshilltarëve të Kuvendit dhe bashkërisht edhe me mua të shkojmë qoftë në ZRRE-në qoftë në KEDS-in dhe ta diskutojmë dhe ta sqarojmë këtë çështje sepse është interes i të gjithë qytetarëve, por jo të ngutemi me vendime të tilla dhe të dëmtojmë investimet e parapara në shumë prej 6.5 milion euro. Unë po ashtu ju tregova se edhe që në vitin 2016 ka qenë një problem i tillë, por që nuk i kemi lejuar të ndërpriten ato investime, e që mendoj se kjo mund të jetë në pjesën e fundit ngase shumë Komuna nuk kanë investime fare nga KEDS për shkak se nuk ka pasë bashkëpunim me Ekzekutivin dhe me Grupet e këshilltarëve të Kuvendeve të Komunave. Kështu që unë mendoj se nuk është mirë të ngutemi ta marrim një vendim të tillë për shkak se dëm i bëjmë vetëm vetit – Komunës së Podujevës dhe qytetarëve në përgjithësi.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk kemi të lajmëruar këshilltarë tjerë për të marrë fjalën, kemi propozim vendimin i cili hyri në rend dite si pikë shtesë dhe i cili u paraqitë nga propozuesi z.Fitim Haziri shef i Grupit të LVV-së, andaj si të tillë e hedh në votim.

Pas procesit të votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se; nga 34 këshilltarë prezent, 17 vota ishin për, 17 vota kundër (por duke përfshirë votën e dyfishtë të Kryesuesit, që e deklaroi kundër), nuk miratohet propozim vendimi që Kompanisë private për distribuim dhe furnizim me energji elektrike, KEDS i ndalohet vendosja e njësorëve për matjen e energjisë elektrike në shtyllat e rrjetit elektrik në hapësirat publike në tërë territorin e Komunës së Podujevës.

Mirëpo pas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal me nr. protokoli 020-253/4 të datës 05.04.2019, sipas të cilës, në bazë të ankesës së këshilltarit z.Fitim Haziri, është konstatuar se është miratuar propozim vendimi në fjalë, dhe i është sugjeruar Kryesuesit të Kuvendit që të njëjtin ta nënshkruaj.

8. Të ndryshme

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marr fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:05

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0019403/19
Podujevë,
04 mars 2019**

**Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi**